**ANEKSI 1C**

**MARRËVESHJA PËR ASPEKTET TREGTARE TË TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE**


PJESA I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PARIMET THEMELORE

PJESA II STANDARDE MBI DISPONUESHMËRINË, FUSHËVEPRIMIN DHE PËRDORIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

1. E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me to
2. Markat tregtare
3. Treguesit gjeografikë
4. Dizenjot industrial
5. Patentat
6. Topografitë e Qarqeve të Integruara
7. Mbrojtja e informacionit konfidencial
8. Kontrolli i praktikave kundër konkurencës në licencat kontraktuale

PJESA III ZBATIMI I TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

1. Detyrimet e Përgjithshme
2. Procedurat civile dhe administrative dhe mjetet juridike
3. Masat e përkohshme
4. Kërkesa të veçanta të lidhura me masat kufitare
5. Procedurat Penale

PJESA IV PËRVETËSIMI DHE MIRËMBAJTJA E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE DHE PROCEDURAT MIDIS PALËVE

PJESA V PARANDALIMI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

PJESA VI MARRËVESHJET KALIMTARE

PJESA VII MARRËVESHJET INSTITUCIONALE; DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

**MARRËVESHJA PËR ASPEKTET TREGTARE TË TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE**

*Anëtarët,*

Me dëshirë për të parandaluar çrregullimet dhe pengesat në tregtinë ndërkombëtare, dhe duke marrë parasysh nevojën për të nxitur mbrojtjen efikase dhe adekuate të të drejtave të pronësisë intelektuale, dhe për të siguruar që masat dhe procedurat për ushtrimin e të drejtave të pronësisë intelektuale si dhe të mos bëhen vetë pengesë për tregtinë legjitime;

*Duke parë, për këtë qëllim, nevojën për rregulla dhe rregullore të reja në lidhje me:*

*(a)* zbatueshmërinë e parimeve bazë të GATT të vitit 1994 dhe të marrëveshjeve apo konventave përkatëse ndërkombëtare për pronësi intelektuale;

(b) sigurimin e standardeve dhe parimeve adekuate për disponueshmërinë, qëllimin dhe përdorimin e të drejtave të pronësisë intelektuale të lidhura me tregtinë;

(c) sigurimin e mjeteve efektive dhe të përshtatshme për zbatimin e aspekteve tregtare të të drejtave të pronësisë industriale, duke marrë parasysh dallimet në sistemet ligjore kombëtare;

(d) sigurimin e procedurave efektive dhe të shpejta për parandalimin dhe zgjidhjen shumëpalëshe të mosmarrëveshjeve ndërmjet qeverive; dhe

(e) marrëveshjet kalimtare qëllimi i të cilave është realizimi i pjesëmarrjes më të plotë në rezultatet e negociatave;

Duke parë nevojën për një kuadër shumëpalësh të parimeve, rregullave dhe disiplinave që kanë të bëjnë me tregtinë ndërkombëtare të mallrave të falsifikuara;

Duke pranuar se të drejtat e pronësisë intelektuale janë të drejta private;

Duke njohur objektivat themelore të politikave publike të sistemeve kombëtare për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, përfshirë edhe objektivat zhvillimore dhe teknologjike;

Duke njohur gjithashtu nevojat e veçanta të vendeve anëtare më pak të zhvilluara për fleksibilitet maksimal në zbatimin vendor të ligjeve dhe rregulloreve për t'i mundësuar krijimin e një bazë teknologjike të fortë dhe të qëndrueshme;

Duke theksuar rëndësinë e uljes së tensioneve përmes arritjes së angazhimeve të përforcuara, marrëveshjet e lidhura me aspektet tregtare të të drejtave të pronësisë intelektuale të zgjidhen përmes procedurave shumëpalëshe;

Me dëshirën për të vendosur një marrëdhënie mbështetëse të ndërsjellë midis OBT-së dhe Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (në pjesën tjetër të tekstit të përmendur edhe si "WIPO") si edhe me organizatat e të tjera ndërkombëtare përkatëse;

Me këtë bien dakord:

# PJESA I

# DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PARIMET THEMELORE

## *Neni 1*

### *Natyra dhe fushëveprimi i detyrimeve*

1. Anëtarët do të sjellin në fuqi dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Anëtarët mund, por nuk janë të detyruar, në ligjet e tyre kombëtare të zbatojnë mbrojtje më të gjerë sesa kërkohet me këtë Marrëveshje, me kusht që një mbrojtje e tillë të mos jetë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Anëtarët do të jenë të lirë të përcaktojnë mënyrën përkatëse të zbatimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje brenda sistemit dhe praktikave të tyre ligjore.

2. Për nevojat e kësaj Marrëveshjeje, termi "pronësi intelektuale" i referohet të gjitha kategorive të pronësisë intelektuale që janë objekt i neneve 1 deri në 7 të pjesës II.

3. Vendet anëtare do t'ua sigurojnë shtetasve të anëtarëve të tjerë trajtimin e parashikuar me këtë Marrëveshje. Lidhur me të drejtat përkatëse të pronësisë intelektuale, si shtetas të vendeve anëtare të tjerë do të konsiderohen ato persona fizikë apo juridik që i plotësojnë kriteret për fitimin e mbrojtjes të parashikuar me Konventën e Parisit (1967), Konventën e Bernës (1971), Konventën e Romës dhe Marrëveshjen për mbrojtjen e pronësisë intelektuale mbi qarqet e integruara, nëse të gjithë Anëtarët e OBT janë nënshkruese edhe të këtyre konventave. Çdo vend anëtar që shfrytëzon mundësitë e parashikuara në paragrafin 3 të nenit 5 apo paragrafin 2 të nenit 6 të Konventës së Romës do t'i paraqesë Këshillit për aspektet tregtare të të drejtave të pronësisë intelektuale (Këshilli i TRIPS), njoftim për këtë, në mënyrën e përshkruar në ato dispozita.

## *Neni 2*

### *Konventat për Pronësinë Intelektuale*

1. Në lidhje me Pjesët II, III dhe IV të kësaj Marrëveshjeje, vendet Anëtare do të veprojnë në përputhje me nenet 1 deri në 12, dhe nenin 19, të Konventës së Parisit (1967).

2. Asgjë në Pjesët I deri në IV të kësaj Marrëveshjeje nuk do të shmanget nga detyrimet ekzistuese që vendet Anëtare mund të kenë ndaj njëri-tjetrit në bazë të Konventës së Parisit, Konventës së Bernës, Konventës së Romës dhe Traktatit për Pronësinë Intelektuale në lidhje me Qarqet e Integruara.

---

[1]Kur "shtetasit" përmenden në këtë Marrëveshje, ata do të konsiderohen, në rastin e një territori doganor të veçantë, Anëtar i OBT-së, pasi nënkuptojnë persona, fizikë ose juridikë, të cilët kanë vendbanim ose që kanë një ndërmarrje reale dhe efektive industriale ose tregtare në atë territor doganor.

[2]Në këtë Marrëveshje, "Konventa e Parisit" i referohet Konventës së Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale; "Konventa e Parisit (1967)" i referohet Aktit të Stokholmit të kësaj Konvente të 14 korrikut 1967. "Konventa e Bernës" i referohet Konventës së Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike; "Konventa e Bernës (1971)" i referohet Aktit të Parisit të kësaj Konvente të 24 korrikut 1971. "Konventa e Romës" i referohet Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Interpretuesve, Prodhuesve të Fonogrameve dhe Organizatave Transmetuese, miratuar në Romë më 26 tetor 1961. "Traktati mbi pronësinë intelektuale në lidhje me qarqet e integruara" (Traktati IPIC) i referohet Traktatit për Pronësinë Intelektuale në lidhje me Qarqet e Integruara, të miratuar në Uashington më 26 maj 1989. "Marrëveshja e OBT-së" i referohet Marrëveshjes për Themelimin e OBT-së.

*Neni 3*

*Trajtimi Kombëtar*

*1.* Çdo vend Anëtar do t'u sigurojë shtetasve të vendeve Anëtare të tjerë trajtim jo më pak të favorshëm se ai që u jep shtetasve të tij në lidhje me mbrojtjen3 e pronësisë intelektuale, duke marë parasysh përjashtimet e parashikuara, përkatësisht, në Konventën e Parisit (1967), Konventën e Bernës (1971), Konventën e Romës ose Traktatin e Pronësisë Intelektuale në lidhje me qarqet e integruara. Në lidhje me artistët, producentët e fonogrameve dhe organizatat transmetuese, ky detyrim zbatohet vetëm për të drejtat e parashikuara në këtë Marrëveshje. Çdo anëtar që shfrytëzon mundësitë e parashikuara në nenin 6 të Konventës së Bernës (1971) ose në paragrafin 1(b) të nenit 16 të Konventës së Romës, do t'i paraqesë një njoftim Këshillit të TRIPS, siç parashikohet në ato dispozita.

2. Vendet Anëtarët mund të shfytëzojnë në procedurat gjyqësore dhe administrative përjashtimet e lejuara sipas paragrafit 1, duke përfshirë caktimin e një adrese për shërbim apo emërimin e një përfaqësuesi (agjenti) brenda juridiksionit të Anëtarit të caktuar, vetëm kur këto përjashtime janë të nevojshme për të siguruar pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret që nuk janë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe ku praktika të tilla nuk zbatohen në mënyrë që do të përbënte një kufizim të fshehur të tregëtisë.

*Neni 4*

*Trajtimi i kombit më të favorizuar*

Në lidhje me mbrojtjen e pronësisë intelektuale, çdo përparësi, favor, privilegj ose imunitet që një vend Anëtar ua siguron shtetasve të cilitdo vendi tjetër, menjëherë dhe pa kushte u sigurohen edhe shtetasve të të gjithë vendeve Anëtare të tjerë. Përjashtohen nga ky detyrim çdo përparësi, favor, privilegj ose imunitet që i siguron ndonjë vend Anëtar:

a. që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare për ndihmë gjyqësore ose zbatimin e ligjit me karakter të përgjithshën që nuk kufizohen veçanërisht në mbrojtjen e pronësisë intelektuale;

b. të siguruara në përputhje me dispozitat e Konventës së Bernës (1971) ose Konventës së Romës duke lejuar që trajtimi i dhënë të mos jetë në funksion të trajtimit kombëtar, por i trajtimit të siguruar në një shtet tjetër;

c. në lidhje me të drejtat e artistëve, producentëve të fonogrameve dhe organizatave transmetuese që nuk parashikohen në këtë Marrëveshje;

d. që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare për mbrojtjen e pronësisë intelektuale të cilat kanë hyrë në fuqi përpara se të hyjë në fuqi Marrëveshja me OBT-së, me kusht që për këto marrëveshje të jetë njoftuar Këshilli TRIPS dhe të mos përbëjnë diskriminim arbitrar ose të pajustifikueshëm për shtetasit e vendeve Anëtare të tjerë.

[3]Për qëllimet e neneve 3 dhe 4, "mbrojtja" do të përfshijë çështjet që prekin disponueshmërinë, përvetësimin, qëllimin, mirëmbajtjen dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe ato çështje që prekin përdorimin e të drejtave të pronësisë intelektuale të trajtuara në mënyrë specifike në këtë Marrëveshje.

*Neni 5*

*Marrëveshjet Shumëpalëshe për Përvetësimin ose Mirëmbajten e Mbrojtjes*

Detyrimet nga nenet 3 dhe 4 nuk zbatohen në procedurat të cilat janë të parashikuara me marrëveshje shumëpalëshe të nënshkruara në kuadër të WIPO, të cilat kanë të bëjnë me marrjen apo mbajtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

*Neni 6*
*Pushimi i të drejtave*

Për qëllime të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas kësaj Marrëveshjeje, në varësi të dispozitave të neneve 3 dhe 4, asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të përdoret për të trajtuar çështjen për pushimin e të drejtave të pronësisë intelektuale.

*Neni 7*
*Objektivat*

Mbrojtja dhe ushtrimi i të drejtave të pronësisë intelektuale duhet të kontribuojë për avancimin e inovacioneve teknologjike dhe për transferimin dhe përhapjen e teknologjisë, të përfitimeve të përbashkëta të prodhuesve dhe përdoruesve të njohurive teknologjike dhe në një mënyrë që kontribuon në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik, si edhe për arritjen e një balance midis të drejtave dhe detyrimeve.

*Neni 8*
*Parimet*

1. Vendet Anëtare, gjatë formulimit ose ndryshimit të ligjeve dhe rregulloreve të tyre, mund të miratojnë masa të domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik dhe të ushqyerit, si dhe për të zhvilluar interesin publik në sektorët me rëndësi jetike për zhvillimin e tyre social-ekonomik dhe teknologjik, me kusht që këto masa të jenë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Masat e duhura, me kusht që të jenë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të jenë të nevojshme për të parandaluar keqpërdorimin e të drejtave të pronësisë intelektuale nga mbajtësit e të drejtave ose përdorimin e praktikave që kufizojnë në mënyrë të paarsyeshme tregtinë ose ndikojnë negativisht mbi transferimin ndërkombëtar të teknologjisë.

# PJESA II

## STANDARDE MBI DISPONUESHMËRINË, FUSHËVEPRIMIN DHE PËRDORIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

### SEKSIONI 1: E DREJTA E AUTORIT DHE TË DREJTAT E LIDHURA ME TO

*Neni 9*

*Raporti me Konventën e Bernës*

1. Anëtarët do të përshtatin nenet 1 deri në 21 të Konventës së Bernës (1971) dhe Aneksin e saj. Megjithatë, Anëtarët nuk do të kenë të drejta ose detyrime sipas kësaj Marrëveshje në lidhje me të drejtat e dhëna sipas nenit 6 të asaj Konvente ose në lidhje me të drejtat që rrjedhin prej saj.

2. Mbrojtja e të drejtës së autorit përfshin shprehjen, e jo idetë, procedurat, metodat e punës apo konceptet matematikore si të tilla.

*Neni 10*

*Programet kompjuterike dhe Përpilimet e të dhënave*

1. Programet kompjuterike, qoftë në kodin burimor ose të përfunduar, do të mbrohen si vepra letrare sipas Konventës së Bernës (1971).

2. Përpilimet e të dhënave ose materialeve të tjera, qofshin ato të lexueshme në mënyre mekanike ose në formë tjetër, që për arsye të zgjedhjes së tyre apo rregullimit të përmbajtjes së tyre përfaqësojnë krijime intelektuale, do të mbrohen si të tilla. Mbrojtja e tillë, e cila nuk ka të bëjë me vetë të dhënat apo materialet, do të jetë e padëmshme mbi cilëndo të drejtë autoriale që është e përmbajtur në të dhënat apo në vetë materialin.

*Neni 11*
*Të drejtat mbi qiradhënien*

Të paktën në lidhje me programet kompjuterike dhe veprat kinematografike, një Anëtar do t'u sigurojë autorëve dhe trashëgimtarëve të tyre, të drejtën për të autorizuar ose ndaluar dhënien me qira komerciale për publikun të origjinaleve ose kopjeve të veprave të tyre me të drejtë autori. Anëtari do të përjashtohet nga ky detyrim në lidhje me veprat kinematografike, përveç rastit kur një dhënie me qira ka çuar në kopjim të gjerë të veprave të tilla, duke dëmtuar materialisht të drejtën ekskluzive të riprodhimit, të cilën autorët dhe trashëgimtarët e tyre e kanë në atë vend Anëtar .Në lidhje me programet kompjuterike, ky detyrim nuk zbatohet për qiratë ku vetë programi nuk është objekti thelbësor i qirasë.

*Neni 12*
*Afati i mbrojtjes*

Në të gjitha rastet kur afati i mbrojtjes së veprave, me përjashtim të veprave fotografike apo të veprave të artit të zbatuar, llogaritet mbi arsye tjetër, dhe jo mbi bazën e jetëgjatësisë së personit fizik, ky afat nuk do të jetë më i shkurtë se 50 vite nga fundi i vitit kalendarik në të cilin është miratuar publikimi, ose në rast se në afatin prej 50 viteve nga krijimi i veprës nuk është dhënë një miratim i tillë, 50 vite nga fundi i vitit kalendarik në të cilin është krijuar vepra.

*Neni 13*
*Kufizime dhe Përjashtime*

Anëtarët do të reduktojnë kufizimet ose përjashtimet nga të drejtat ekskluzive për raste të veçanta që nuk janë në kundërshtim me shfrytëzimin normal të veprës dhe nuk përfaqësojnë dëm të paarsyeshëm për interesat legjitime të mbajtësit të së drejtës.

*Neni 14*

*Mbrojtja e performuesve(artistëve), producentëve të fonogrameve (regjistrime zanore) dhe organizatave transmetuese*

1. Në lidhje me incizimin (regjistrimin) e performancës së tyre në fonogram, performuesit(artistët) kanë mundësi të pengojnë procedurat në vijim, kur ato merren pa autorizimin e tyre: regjistrimin e performimeve të tyre të paregjistruara dhe riprodhimin e regjistrimeve të tilla. Performuesit, gjithashtu, do të kenë mundësinë për të penguar procedurat vijuese që merren pa autorizimin e tyre: emetimin- transmetimin pa tel dhe transmetimin publik të performimeve të tyre të drejtpërdrejta.

2. Producentët e fonogrameve kanë të drejtë të lejojnë ose ndalojnë drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë riprodhimin e fonogrameve të tyre.

3. Organizatat transmetuese kanë të drejtë të ndalojnë veprimet në vijim, në raste kur ndërmerren pa lejen e tyre: regjistrimin, riprodhimin e xhirimeve dhe ritransmetimin e xhirimeve përmes mjeteve të transmetimit pa tela, si edhe transmetimin publik të xhirimeve televizive të të njëjtave. Në rastet kur Anëtarët nuk i japin këto të drejta organizatave transmetuese, ata do t'i mundësojnë mbajtësve të të drejtave autoriale në fushën e transmetimeve që t'i ndalojnë veprimet e mësipërme, subjekt i dispozitave të Konventës së Bernës (1971).

4. Dispozitat e nenit 11 në lidhje me programet kompjuterike do të zbatohen mutatis mutandis për producentët e fonogrameve dhe të gjithë mbajtësve tëtjerë të të drejtave në fushën e fonogrameve, të përcaktuara me ligjin e vendit Anëtarë. Nëse më 15 prill 1994 në ndonjë vend Anëtarë ishte në fuqi ndonjë sistem i kompensimit të drejtë për mbajtësit e të drejtave në lidhje me huazimet e fonogrameve, ai mund të mbajë atë sistem, me kusht që dhënia me qera tregëtare e fonogrameve të mos nxisë shkelje të mëdha të të drejtave ekskluzive të riprodhimit të mbajtësve tëtë drejtave.

5. Mbrojtja, e cila në bazë të kësaj marrëveshje i jepet përformuesve dhe producentëve të fonogrameve, do të zgjasë së paku deri në fund të periudhës prej 50 vite, të llogaritura nga fundi i vitit kalendarik në të cilin është krijuar regjistrimi ose në të cilin ka ndodhur performimi. Afati i mbrojtjes i paraparë sipas pikës 3, do të zgjasë së paku 20 vite nga fundi i vitit në të cilin është bërë transmetimi.

6. Çdo vend Anëtar, në lidhje me të drejtat e dhëna sipas paragrafëve 1, 2 dhe 3, mund të parashikojë kushte, kufizime, përjashtime dhe rezerva në masën e lejuar nga Konventa e Romës. Megjithatë, dispozitat e nenit 18 të Konventës së Bernës (1971) do të zbatohen gjithashtu, mutatis mutandis, për të drejtat e performuesve dhe producentëve të fonogrameve në lidhje me fonogramat.

## SEKSIONI 2: MARKAT TREGTARE

### *Neni 15*

### *Subjekti i Mbrojtur*

1. Çdo shenjë ose çdo kombinim shenjash, me të cilat mund të dallohen mallrat ose shërbimet e një ndërmarrjeje nga ato të ndërmarrjeve të tjera, duhet të jetë në gjendje për të përfaqësuar një markë tregtare. Shenja të tilla, në veçanti fjalë që përfshijnë emrat personalë, shkronjat, numrat, elementet figurative dhe kombinimet e ngjyrave, si dhe çdo kombinim i shenjave të tilla, do të jenë të pranueshme për regjistrim si marka tregtare. Kur shenjat nuk janë në thelb të afta për të dalluar mallrat ose shërbimet përkatëse, vendet Anëtare mund të kushtëzojnë regjistrimin edhe me dallueshmërinë e arritur gjatë përdorimit. Anëtarët mund të kërkojnë, si kusht regjistrimi, që shenjat të jenë vizualisht të perceptueshme.

2. Paragrafi 1 nuk do të interpretohet sikur pengon vendin Anëtarë të refuzojë regjistrimin e markës tregtare në baza të tjera, me kusht që me këtë të mos kryhet devijim nga dispozitat e Konventës së Parisit (1967)

3. Vendet Anëtare mund të kushtëzojnë që regjistrimi të varet nga përdorimi. Megjithatë, përdorimi aktual i një marke tregtare nuk do të jetë kusht për paraqitjen e një aplikimi për regjistrim. Një aplikim nuk do të refuzohet vetëm me arsyetimin se përdorimi i synuar nuk është bërë përpara përfundimit të një periudhe prej tre vjetësh nga data e aplikimit.

4. Natyra e mallrave ose e shërbimeve për të cilat do të aplikohet një markë tregtare nuk përbën në asnjë rast pengesë për regjistrimin e markës tregtare.

5. Anëtarët do të publikojnë çdo markë tregëtare ose përpara se të regjistrohet ose menjëherë pasi të jetë regjistruar dhe do të sigurojnë një mundësi të arsyeshme për paraqitjen e kërkesave për anulimin e regjistrimit. Përveç kësaj, vendet Anëtare mund të sigurojnë mundësinë për paraqitjen e ankesës për markën e regjistruar tregtare.

### *Neni 16*

### *Të Drejtat e dhëna*

1. Pronari i një marke të regjistruar tregtare ka të drejtën ekskluzive të parandalojë të gjitha palët e treta që nuk kanë pëlqimin e tij të përdorin gjatë tregtisë shenja identike ose të ngjashme për mallra ose shërbime, që janë identike ose të ngjashme me ato për të cilat është regjistruar marka tregtare, në rastet kur ekziston mundësia që përdorimi i tillë do të mund të çoj në konfuzion. Në rast të përdorimit të një shenje identike për mallra ose shërbime identike, supozohet mundësia e konfuzionit. Të drejtat e lartpërmendura nuk do të dëmtojnë asnjë të drejtë ekzistuese paraprake, as nuk do të ndikojnë në mundësinë që kanë vendet Anëtare që t'i kushtëzojnë të drejtat e përdorimit.

2. Neni 6 i Konventës së Parisit (1967) do të zbatohet, mutatis mutandis, edhe për shërbimet. Në përcaktimin nëse një markë tregtare është e njohur, vendet Anëtare do të marrin parasysh njohuritë e markës tregtare në sektorin përkatës të publikut, duke përfshirë njohuritë e anëtarit në fjalë që janë marrë si rezultat i promovimit të markës tregtare.

3. Neni 6 i Konventës së Parisit (1967) do të zbatohet, mutatis mutandis, për mallrat ose shërbimet që nuk janë të ngjashme me ato për të cilat është regjistruar një markë tregtare, me kusht që përdorimi i asaj marke tregtare në lidhje me atë mall ose shërbim të tregojë lidhje ndërmjet këtyre mallrave ose shërbimeve dhe pronarit të markës së regjistruar tregtare dhe me kusht që të ekzistojë mundësi që me përdorimin e tillë do të dëmtohen interesat e mbajtësit të së drejtës së markës së regjistruar tregtare.

*Neni 17*

*Përjashtime*

Vendet anëtare mund të parashikojnë përjashtime të kufizuara për të drejtat që merren me markën tregtare, siç është përdorimi i drejtë i shprehjeve përshkruese, me kusht përjashtimet e tilla të marrin parasysh interesat legjitime të pronarit të markës tregtare dhe të personave të tretë.

*Neni 18*

*Kohëzgjatja e mbrojtjes*

Regjistrimi fillestar dhe çdo rinovim i regjistrimit të markës tregtare do të jetë për periudhë prej të paktën shtatë vite. Regjistrimi i markës tregtare mund të rinovohet pafundësisht.

*Neni 19*

*Kërkesat për Përdorim*

1. Nëse kërkohet përdorimi për të mbajtur një regjistrim të caktuar, regjistrimi mund të anulohet vetëm pas periudhës së pandërprerë të mospërdorimit të markës tregtare prej të paktën tre viteve, përveç kur pronari i së drejtës së markës tregtare do të paraqesë arsye të vlefshme të bazuara në ekzistencën e pengesave për atë përdorim. Si arsye të vlefshme për mospërdorimin e markës tregtare do të pranohen rrethanat e paraqitura pavarësisht vullnetit të pronarit të së drejtës të markës tregtare, që përfaqësojnë pengesa për përdorimin e markës tregtare, siç janë kufizimet në importe apo kushtëzime të tjera qeveritare në lidhje me mallin e mbrojtur me markë tregtare.

2. Në rastet kur përdorimi i një marke të caktuar tregtare është nën kontrollin e pronarit të së drejtës, përdorim i saj nga ana e një personi tjetër do të pranohet si përdorim i markës tregtare për nevojat e mbajtjes së regjistrimit.

*Neni 20*

*Kushte të tjera*

Përdorimi i markave tregtare në tregti nuk do të kufizohet padrejtësisht me kërkesa të veçanta, siç janë përdorimi me një markë tjetër tregtare, përdorim në formë të veçantë, apo përdorimi në mënyrë që zvogëlon aftësinë e markës tregtare të tregojë dallimin midis mallrave apo shërbimeve të një ndërmarrje dhe atyre të një ndërmarrje tjetër. Kjo nuk do të shkojë në dëm të ndonjë kushti të caktuar me të cilin përshkruhet përdorimi i markës tregtare me të cilën identifikohet ndërmarrja që prodhon mallrat apo shërbimet bashkë me, por pa mos e lidhur me të, markën tregtare sipas së cilës dallohen mallrat apo shërbimet konkrete të asaj ndërmarrje për të cilën bëhet fjalë.

*Neni 21*

*Dhënia e licencave dhe caktimi i së drejtës*

Vendet Anëtare mund të caktojnë kushtet për dhënien e licencave dhe caktimin e të drejtave të markave tregtare, duke nënkuptuar se nuk do të lejohet licencimi i detyrueshëm për marka tregtare dhe se pronari i markës së regjistruar tregtare do të ketë të drejtën të caktojë (transferoj) markën tregtare, me ose pa transferimin e aktiviteteve të biznesit të cilave i takon marka tregtare.

SEKSIONI 3: TREGUESIT GJEOGRAFIK

*Neni 22*

*Mbrojtja e treguesve gjeografikë*

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshje, treguesit gjeografik janë ato tregues që tregojnë se malli ka origjinë nga territori i një vendi të caktuar Anëtar ose rajoni ose lokalitetit i atij territori, ku cilësia e dhënë, reputacioni ose ndonjë karakteristikë tjetër e mallit i atribuohet në thelb origjinës së tij gjeografike.

2. Në lidhje me treguesit gjeografik, vendet Anëtare do t'i sigurojnë palëve të interesuara mjete juridike për të parandaluar:

(a) përdorimin e çdo mjeti gjatë përcaktimit apo paraqitjes së mallit që tregon apo sugjeron se malli për të cilin bëhet fjalë ka origjinë nga rajoni i caktuar gjeografik që nuk është vendi i vërtetë i origjinës, në mënyrë që e fut publikun në konfuzion në lidhje me prejardhjen gjeografike të mallit;

(b) çdo përdorim që përfaqëson një akt të konkurrencës së pandershme sipas kuptimit të nenit 10 të Konventës së Parisit (1967).

3. Vendi Anëtar, ex officio në rast se legjislacioni i tij e lejon atë ose me kërkesë të ndonjë pale të interesuar, do të refuzojë apo anulojë regjistrimin e markës tregtare që përmban apo përbëhet nga emërtimi gjeografik për mallra që nuk kanë prejardhje nga territori i treguar, nëse përdorimi i atij treguesi të markës tregtare për atë mall në atë vend Anëtarë është i asaj natyre që mund të krijojë konfuzion për publikun në lidhje me vendin e vërtetë të prejardhjes.

4. Mbrojtja në bazë të paragrafëve 1,2 dhe 3 do të zbatohet mbi treguesin gjeografik, që megjithëse gjuhësisht e saktë sa i përket territorit, rajonit apo lokalitetit prej nga ka origjinën malli, në mënyrë të rreme i paraqet publikut se malli ka prejardhje nga një territor tjetër.

*Neni 23*

*Mbrojtja shtesë për treguesit gjeografikë për verërat dhe pijet alkoolike*

1. Çdo vend anëtar do t'i sigurojë palëve të interesuara mjete ligjore për parandalimin e përdorimit të treguesve (emërtimeve) gjeografike të cilat verën e identifikojnë si verë që nuk ka prejardhje nga vendi i treguar në atë emërtim gjeografik ose që pijen alkoolike e identifikon si pije alkoolike që nuk ka prejardhjen nga vendi i treguar në atë emërtim gjeografik, madje edhe në rastet kur është treguar prejardhja e vërtetë e mallit ose kur emërtimi gjeografik përdoret në përkthim ose i shoqëruar me shprehje siç janë: "lloj", "tip", "stil", "imitim" ose të ngjashme[4]

2. Regjistrimi i markës tregtare për verën që përmban ose përbëhet nga emërtimi gjeografik që e identifikon verën, ose markës tregtare për pije alkoolike që përmban ose përbëhet nga emërtimi gjeografik që identifikon pijet alkoolike, do të refuzohet ose anulohet ex officio, nëse lejon legjislacioni vendor i vendit të caktuar Anëtarë, ose me kërkesë të palës së interesuar, për verërat apo pijet alkoolike që nuk janë me atë prejardhje të treguar.

3. Në rastet e emërtimeve homonime gjeografike për verërat do të sigurohet mbrojtje për çdo emërtim, subjekt i dispozitave të nenit 22, paragrafi 4. Çdo vend Anëtarë do të përcaktojë kushte praktike në bazë të të cilave emërtimet homonime (me të njëjtin emër) për të cilat bëhet fjalë do të dallohen nga njëri tjetri, duke marrë parasysh nevojën për të siguruar trajtim të barabartë të prodhuesve për të cilët bëhet fjalë dhe konsumatorët të mos vendosen në konfuzion.

4. Për të lehtësuar mbrojtjen e treguesve gjeografikë për verërat, në Këshillin për TRIPS do të ndërmerren negociatat në lidhje me krijimin e një sistemi shumëpalësh të njoftimit dhe regjistrimit të treguesve gjeografikë për verërat që plotësojnë kushtet për mbrojtje në ato vende Anëtare që marrin pjesë në sistem.

*Neni 24*

*Negociatat Ndërkombëtare; Përjashtimet*

1. Anëtarët bien dakord të hyjnë në negociata që synojnë rritjen e mbrojtjes së treguesve individualë gjeografikë sipas nenit 23. Një vend anëtar nuk do të përdorë dispozitat e paragrafëve 4 deri në 8 më poshtë për të refuzuar zhvillimin e negociatave ose për të arritur marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe. Në kontekstin e negociatave të tilla, vendet anëtare do të jenë të gatshëm të marrin në konsideratë zbatueshmërinë e vazhdueshme të këtyre dispozitave për treguesit gjeografikë individualë, përdorimi i të cilëve ishte subjekt i këtyre negociatave.

2. Këshilli i TRIPS do të shqyrtojë zbatimin e dispozitave të këtij Seksioni; shqyrtimi i tillë i parë do të bëhet brenda 2 viteve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së OBT-së. Çdo çështje që ndikon në respektimin e detyrimeve sipas këtyre dispozitave mund t'i drejtohet Këshillit, i cili, me kërkesë të vendit të caktuar Anëtar, do të konsultohet me çdo vend tjetër Anëtar , në lidhje me një çështje të tillë në për të cilën nuk do të ishte e mundur të gjendej një zgjidhje e kënaqshme nëpërmjet konsultimeve dypalëshe ose shumëpalëshe ndërmjet vendeve përkatëse anëtarëve. Këshilli do të ndërmerr të gjitha masat e miratuara për të lehtësuar funksionimin dhe për të avancuar qëllimet e këtij seksioni.

3. Gjatë zbatimit të këtij seksioni, vendi anëtar nuk do të zvogëlojë mbrojtjen e treguesve gjeografikë që kanë ekzistuar në atë vend Anëtar përpara hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së OBT-së.

---

[4]Pavarësisht nga fjalia e parë e nenit 42, anëtarët, në lidhje me këto detyrime, në vend të kësaj mund të parashikojnë zbatimin me veprim administrativ.

4. Asgjë në këtë seksion nuk do të detyrojë vendin Anëtarë të parandalojë përdorimin e vazhdueshëm dhe të ngjashëm të treguesit të caktuar gjeografik të ndonjë vendi tjetër Anëtarë që identifikon verërat apo pijet alkoolike në lidhje me mallrat apo shërbimet që i sigurojnë kushdo nga shtetasit apo rezidentët e tij që atë tregues gjeografik e kanë përdorur në mënyrë të vazhdueshme për mallin apo shërbimin e njëjtë apo të ngjashëm në territorin e atij vendi anëtarë ose (a) së paku dhjetë vite para 15 prillit të vitit 1994 ose (b) me qëllim të mirë para asaj date.

5. Në rastet kur marka tregtare është përdorur ose është regjistruar me qëllim të mirë, ose kur të drejtat e markës tregtare janë fituar përmes përdorimit të saj në mënyrë të ndërgjegjshme, ose:

(a) para datës së zbatimit të këtyre dispozitave në atë vend Anëtarë, siç është përcaktuar në pjesën VI; ose

(b) para se treguesi gjeografik të mbrohet në vendin e tij të origjinës;

masat e miratuara për implementimin e këtij seksioni nuk do të jenë në dëm të pranueshmërisë apo vlefshmërisë së regjistrimit të markës tregtare, ose të së drejtës së përdorimit të markës tregtare, në bazë të faktit se ajo markë tregtare është identike me, ose e ngjashme me, ndonjë tregues gjeografik.

6. Asgjë në këtë seksion nuk detyron vendin Anëtar të zbatojë dispozitat e kësaj Seksioni për ndonjë tregues gjeografik të çdo vendi tjetër anëtarë në lidhje me mallrat apo shërbimet për të cilat ai tregues është identik me termin që është i zakonshëm në gjuhën e përditshme në territorin e atij vendi Anëtarë si emër i shpeshtë për mallra apo shërbime të tilla. Asgjë në këtë nënpjesë nuk do të detyrojë vendin Anëtarë të zbatojë dispozitat e këtij seksioni në lidhje me treguesin gjeografik të çdo vendi tjetër për produktet e verës për të cilat ai tregues është identik me emrin e zakonshëm të llojit të rrushit që ekziston në territorin e atij vendi Anëtarë në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së OBT-së

7. Vendi anëtar mund të parashikojë që çdo kërkesë e bërë në bazë të këtij seksioni në lidhje me përdorimin apo regjistrimin e markës tregtare duhet të jetë parashtruar në afat prej pesë viteve pasi përdorimi i palejuar i treguesit të mbrojtur të jetë bërë gjerësisht i njohur në atë vend Anëtar ose nga data e regjistrimit të markës tregtare në atë vend Anëtarë, me kusht që marka tregtare të jetë e publikuar deri në atë datë, nëse ajo datë është më e hershme se data kur përdorimi i palejuar është bërë gjerësisht i njohur në atë vend Anëtarë, me kusht treguesi gjeografik të mos jetë përdorur apo regjistruar me qëllim të keq
8. Dispozitat e këtij seksioni në asnjë mënyrë nuk do të cënojnë të drejtën e çdo personi të përdorë, në rrjedhën normale të tregtisë, emrin e tij apo emrin e paraardhësit të tij në veprimtarinë që e kryen, përveç në rastet kur ai emër përdoret në mënyrë që ka për qëllim ta vendosë publikun në konfuzion.

9. Me këtë Marrëveshje nuk do të ketë detyrime shtesë për të mbrojtur treguesit gjeografike që në vendet e tyre të origjinës nuk janë të mbrojtura, ose janë ndërprerë së mbrojturi, ose të cilat në atë vend janë ndërprerë së përdoruri.

## SEKSIONI 4: DIZENJOT INDUSTRIALE

### *Neni 25*

### *Kushtet për mbrojtje*

1. Vendet anëtare do të sigurojnë mbrojtje të dizenjove industriale të krijuar në mënyrë të pavarur, të rinj ase origjinalë. Vendet anëtare mund të sigurojnë që një dizenjo i caktuar industrial të mos konsiderohet si i ri ose origjinal nëse nuk dallon dukshëm nga ndonjë dizenjo i njohur industrial apo kombinim i karakteristikave të ndonjë dizenjoi të njohur. Vendet anëtare mund të parashikojnë që mbrojtja e tillë të mos përfshijë dizenjo industrial që parimisht është diktuar nga nevojat dhe mundësitë teknike apo funksionale.

2. Çdo vend anëtarë do të sigurojë që kushtet për sigurimin e mbrojtjes për dizenjo tekstili, sidomos në lidhje me shpenzimet e mundshme, ekzaminimet ose publikimet, të mos pengojnë pa qene e nevojshme mundësinë për të kërkuar apo fituar atë mbrojtje. Vendet anëtare do të jenë të lira të plotësojnë këtë detyrim përmes ligjeve për dizenjo industrial ose për të drejtat e autorit.

*Neni 26*

*Mbrojtja*

1. Zotëruesi i dizenjos të mbrojtur industrial do të ketë të drejtën të parandalojë personat e tretë që nuk kanë pëlqimin e tij, të prodhojnë , të shesin ose të importojnë mallra që përmbajnë ose që personifikojnë një dizenjo që është kopje, ose në esencë kopje e dizenjoit të mbrojtur, kur veprime të tilla ndërmerren për qëllime komerciale.

2. Vendet anëtare mund të parashikojnë përjashtime të kufizuara nga mbrojtja e dizenjoit industrial, me kusht këto përjashtime të mos jenë të paarsyeshme në lidhje me shfytëzimin normal të dizenjoëve të mbrojtur industrialë dhe të mos jenë të paarsyeshme në dëm të interesave legjitime komerciale të zotëruesit të dizenjoit të mbrojtur industrial, duke marrë parasysh interesat legjitime të palëve të treta.

3. Kohëzgjatja e mbrojtjes do të jetë së paku 10 vite.

SEKSIONI 5: PATENTAT

*Neni 27*

*Subjekt i mbrojtjes me patentë*

1. Në përputhje me dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3, patentë mund të merret për shpikje, qofshin ato produkte apo procese, në të gjitha fushat e teknologjisë, me kusht që të jenë të reja, të përmbajnë një hap inovativ, dhe të jenë të përshtatshme për zbatim industrial. Në përputhje me paragrafin 4 të nenit 65, paragrafin 8 të nenit 70 dhe paragrafin 3 të këtij neni, patentat do të jenë në dispozicion dhe të drejtat e patentave do të mund të përdoren pa diskriminim në raport me vendin e shpikjes, fushën e teknologjisë dhe pa dallim për sa bëhet fjalë për produkte të importuara apo produkte të prodhuara lokale.

2. Vendet anëtare mund të përjashtojnë nga mbrojtja me patentë ato shpikje në raport me të cilat është e domosdoshme të parandalohet shfrytëzimi komercial i territorit të tyre për të mbrojtur rendin apo moralin publik, duke përfshitë mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve, kafshëve apo bimëve ose për të shmangur dëmtimin serioz të mjedisit jetësor, me kusht përjashtimi të mos bëhet vetëm pse shfrytëzimi është i ndaluar me ligjin kombëtar.

3. Vendet anëtare mund të përjashtojnë nga mbrojtja me patentë edhe:

(a) metodat diagnostikuese, terapeutike dhe kirurgjike të shërimit njerëzve dhe kafshëve;

(b) bimët dhe kafshët, përveç mikroorganizmave, dhe në esencë proceset biologjike për prodhimin e bimëve apo kafshëve, përveç proceseve jo-biologjike dhe mikrobiologjike. Megjithatë, vendet anëtare do të sigurojnë mbrojtje të llojeve të bimëve, ose me sistem sui generis adekuat, ose me kombinimin e tyre. Dispozitat nga ky nënparagraf do të rishikohen çdo katër vjet pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së OBT-së.

[5] Për qëllimet e këtij neni, termat "hap shpikës" dhe "i aftë për aplikim industrial" mund të konsiderohen nga një anëtar si sinonim me termat respektivë "jo e qarte" dhe "i dobishëm".

*Neni 28*

*Të drejtat e dhëna*

1. Patenta do t'i sigurojë pronarit të tij të drejtat ekskluzive në vijim:

(a) kur subjekti i patentës është produkt, të drejtën për të parandaluar persona të tretë që nuk kanë pëlqimin e tij të kryejnë veprime të: prodhimit të atij produkti, përdorimit të tij, ofrimit për shitje, shitjes, ose importit për qëllime të tilla;

(b) kur subjekti i patentës është proces, të drejtën për të parandaluar personat e tretë që nuk kanë pëlqimin e tij të kryejnë veprime të përdorimit të procedurës, si edhe veprime të: përdorimit, ofrimit për shitje, shitjes apo importit për këto qëllime të paktën të produktit që drejtpërdrejt është fituar me atë proces.

2. Pronarët e patentës gjithashtu kanë të drejtën të bartin (caktojnë) patentën ose të transferojnë përmes trashëgimisë, si edhe të lidhin marrëveshje licencash.

*Neni 29*

*Kushtet për Aplikantët e Patentave*

1. Vendet anëtare do të kërkojnë që aplikant i kërkesës për patentë të zbulojë shpikjen në mënyrë që do të jetë mjaftueshëm i qartë dhe i plotë që shpikja të mund të realizohet nga një person që është profesionist në atë fushë, dhe mund të kërkojnë nga aplikanti i kërkesës që të tregojë mënyrën më të mirë për realizimin e shpikjes të njohur nga shpikësi në kohën e paraqitjes së kërkesës ose, në rast të kërkese për prioritet, në datën e prioritetit të kërkesës.

2. Vendet anëtare mund të kërkojnë nga aplikanti i kërkesës për patentë të dorëzojë të dhëna që kanë të bëjnë me aplikimet dhe të drejtat e regjistruara adekuate të huaja.

*Neni 30*

*Përjashtime në lidhje me të drejtat e dhëna*

Vendet anëtare mund të sigurojnë përjashtime të kufizuara në lidhje me të drejtat ekskluzive të dhëna me patentë, me kusht përjashtimet e tilla të mos bien paarsyeshëm në konflikt me shfrytëzimin e zakonshëm të patentës dhe të mos shkaktojnë dëm të paarsyeshëm mbi interesat legjitime të pronarit të patentës, duke mbajtur llogari për interesat legjitime të palëve të treta.

[6] Kjo e drejtë, si të gjitha të drejtat e tjera të dhëna sipas kësaj Marrëveshjeje në lidhje me përdorimin, shitjen, importimin ose shpërndarjen e mallrave, i nënshtrohet dispozitave të nenit 6.

*Neni 31*

*Përdorime të tjera pa autorizim të mbajtësit të së drejtës*

Në rastet kur ligji i një vendi anëtar lejon lloj tjetër të përdorimit të subjektit së patentës së dhënë pa autorizim nga mbartësi i së drejtës, duke përfshirë përdorimin nga ana e qeverisë ose të palëve të treta të autorizuara nga qeveria, do të respektohen dispozitat në vijim:

(a) Autorizimi i përdorimit të tillë do të shqyrtohet në veçanti për çdo rast;

(b) përdorimi i tillë mund të lejohet vetëm nëse, para këtij përdorimit, përdoruesi i propozuar ka bërë përpjekje për të marrë autorizimin nga mbartësi i së drejtës nën kushte dhe afate të pranueshme komerciale dhe nëse ajo përpjekje nuk ka rezultuar me sukses në periudhë të arsyeshme kohore. Nga ky kusht vendi Anëtar mund të heq dorë në rast të gjendjes së jashtëzakonshme në vend ose në rrethana të tjera të jashtëzakonshme ose në raste të përdorimit publik jokomercial. Në rast të gjendjes së jashtëzakonshme në vend ose në rrethana të tjera të jashtëzakonshme, mbartësi megjithatë duhet menjëherë të njoftohet, menjëherë sapo praktikisht të jetë e mundur. Në rast të përdorimit publik jokomercial, kur qeveria ose ndonjë person i kontraktuar, pa bërë një kërkim për patentë, e dinë ose kanë baza të provueshme të dinë se një patentë e vlefshme përdoret ose do të përdoret nga qeveria ose për qeverinë, mbajtësi i së drejtës do të njoftohet menjëherë;

(c) qëllimi dhe kohëzgjatja e përdorimit të tillë të jetë i kufizuar në qëllimet për të cilat është marrë autorizimi, ndërsa në rastet e teknologjisë gjysmëpërçuese vetëm për përdorim publik jokomercial ose për të korrigjuar një praktikë për të cilën në procedurë gjyqësore ose administrative është vërtetuar se është antikonkuruese;

(d) përdorimi i tillë të mos jetë ekskluzivë;

(e) një përdorim i tillë do të jetë i pacaktueshëm, përveç asaj pjese të ndërmarrjes ose emrit të mirë që gëzon një përdorim të tillë;

(f) çdo përdorim i tillë të lejohet kryesisht për furnizimin e tregut vendor të vendit Anëtar që e autorizon përdorimin;

(g) autorizimet për këto përdorime të jenë subjekt, nën mbrojtjen adekuate të interesave legjitime të personave që kanë aso autorizimi, në mundësinë të revokohet nëse dhe kur të ndalojnë së ekzistuari rrethanat që kanë sjellë në ato autorizime dhe nëse është pak e mundshme që sërish do të paraqiten. Organi kompetent ka autorizime të rishikojë, në bazë të kërkesës së arsyetuar, ekzistencën e vazhduar e këtyre rrethanave;

(h) mbajtësit të së drejtës t'i paguhet kompensim adekuat sipas rrethanave në çdo rast të veçantë, duke marrë parasysh vlerën ekonomike të autorizimit;

(i) Vlefshmëria ligjore e çdo vendimi në lidhje me autorizimet për atë përdorim, të jetë subjekt i rishikimit gjyqësor apo ndonjë rishikimi tjetër të pavarur nga ana e ndonjë instance më të lartë në atë vend anëtar;

(j) çdo vendim që ka të bëjë me kompensimin e paraparë për përdorimin e tillë të nënshtrohet në rishikim gjyqësor ose në ndonjë rishikim tjetër të pavarur nga ndonjë instancë e veçantë më e lartë e atij vendi anëtar;

[7] "Përdorim tjetër" i referohet përdorimit të ndryshëm nga ai i lejuar sipas nenit 30.

(k) Vendet anëtare nuk janë të detyruara të zbatojnë kushtet e përcaktuara në nënparagrafet (b) dhe (f), në rastet kur përdorimi i tillë është i lejuar për të korrigjuar një praktikë për të cilën në procedurë gjyqësore ose administrative është vërtetuar se është anti-konkurruese. Gjatë përcaktimit të kompensimit për këto raste mund të merret parasysh nevoja për të korrigjuar procedurën e caktuar anti-konkurruese. Organet kompetente kanë autorizime të refuzojnë anulimin e autorizimit nëse dhe kur ekziston mundësia sërish të paraqiten rrethanat që sollën në lëshimin e asaj leje;

(l) kur përdorimi i tillë është i autorizuar për të mundësuar shfrytëzimin e ndonjë patente ("patenta e dytë") që nuk mund të shfrytëzohet pa shkaktuar dëmtim të ndonjë patente tjetër ("patenta e parë"), do të zbatohen kushtet plotësuese në vijim:

(i) Shpikja e pretenduar në patentën e dytë do të përfshijë një avancim të rëndësishëm teknologjik të rëndësisë së madhe ekonomike, në lidhje me shpikjen e pretenduar në patentën e parë;

(ii) Mbartësi i patentës së parë do të ketë të drejtën në licencë të kryqëzuar nën kushte të pranueshme të përdor shpikjen e patentës së dytë; dhe

(iii) Përdorimi i lejuar në patentën e parë të mos jetë i transferueshëm, përveç në rast të transferim (bartjes) së patentës së dytë.

*Neni 32*

*Revokimi / Konfiskimi*

Do të ekzistojnë mundësi për rishikim gjyqësor të të gjitha vendimeve për anulimin ose konfiskimin e patentës.

*Neni 33*

*Kohëzgjatja e mbrojtjes*

Kohëzgjatja e mbrojtjes që mund të miratohet nuk mund të përfundojë para përfundimit të periudhës prej 20 viteve të llogaritura nga data e paraqitjes së kërkesës.[8]

*Neni 34*

*Patentat e procesit: detyrim për t'u provuar (Barra e Provës)*

1. Për qëllime të procedurës civile në lidhje me shkeljen e së drejtës së pronarit të patentës nga paragrafi 1 (b) i nenit 28, nëse subjekt i patentës është procesi për fitimin e ndonjë produkti, organet gjyqësore do të kenë autorizimet t'i urdhërojnë palës së paditur të dëshmojë se procesi i fitimit të ndonjë produkti identik është ndryshe nga procesi i patentuar. Sipas kësaj, vendet Anëtare kanë barrën e provës të sigurojnë, të paktën në një nga rrethanat vijuese, që çdo produkt identik, kur prodhohet pa pëlqimin e mbajtësit të patentës dhe në mungesë të dëshmive për të kundërtën, të konsiderohet si i fituar me proces të patentuar:

[8] Kuptohet që ata anëtarë që nuk kanë një sistem granti origjinal mund të parashikojnë që afati i mbrojtjes do të llogaritet nga data e depozitimit në sistemin e grantit origjinal.

(a) nëse produkti i fituar me proces të patentuar është i ri;

(b) nëse ekziston mundësi e theksuar që produkti identik është prodhuar me atë proces dhe se pronari i patentës nuk ka qenë në gjendje përmes përpjekje të arsyeshme të përcaktoj se procesi në fakt është shfrytëzuar.

2. Çdo vend anëtar do të jetë i lirë të parashikojë që barra e provës e treguar në paragrafin 1 do të jetë mbi shkelësin e pretenduar vetëm nëse kushti i përmendur në nënparagrafin (a) plotësohet ose vetëm nëse është plotësuar kushti i përmendur në nënparagrafin (b).

3. Gjatë paraqitjes së dëshmive për të kundërtën, do të merren parasysh interesat legjitime të palës së paditur për të mbrojtur produktet e saj dhe sekretet e biznesit.

## SEKSIONI 6: SKEMAT E QARQEVE TË INTEGRUARA (TOPOGRAFIVE)

### *Neni 35*

### *Marrëdhënia me Traktatin IPIC*

Vendet anëtare pajtohen të sigurojnë mbrojtjen e skemave (topografive) të qarqeve të integruara (në tekstin e mëposhtëm "skemat") në pajtueshmëri me nenet 2 deri 7 (përveç paragrafi 3 i nenit 6), nenin 12 dhe paragrafi 3 i nenit 16 të Konventës për mbrojtjen e pronësisë intelektuale të qarqeve të integruara dhe, përveç kësaj, të harmonizohen me dispozitat e mëposhtme.

### *Neni 36*

### *Shtrirja e mbrojtjes*

Në bazë të dispozitave të paragrafit 1 të nenit 37, vendet anëtare do t'i konsiderojnë si joligjore veprimet vijuese, nëse kryhen pa lejen e mmbajtësit të së drejtës: importi, shitja apo ndonjë lloj tjetër shpërndarje për qëllime komerciale të skemave të mbrojtura, të qarkut të integruar në të cilin është përfshirë skema e mbrojtur, ose të produktit që përfshin një qark të tillë të integruar, vetëm nëse vazhdon të përmbajë skemë joligjore riprodhuese.

### *Neni 37*

### *Veprime për të cilat nuk është i nevojshëm autorizimi nga mbajtësi i së drejtës*

1. Pa marrë parasysh nenin 36, asnjë vend anëtar nuk do të konsiderojë si joligjore kryerjen e çdo veprimi për të cilët flitet në atë nen në lidhje me qarkun e integruar që ka të inkorporuar skemë riprodhuese joligjore, ose cilindo produkt në të cilin është inkorporuar një qark i tillë integrues, në rastet kur personi që kryen apo porosit veprime të tilla të mos ketë ditur dhe të mos ketë pasur bazë të arsyeshme të dijë gjatë fitimit të qarkut të integruar apo produktit në të cilin është inkorporuar një qark i tillë i integruar, se kjo përmban skemë riprodhuese joligjore. Vendet anëtare do të sigurojnë se, pas momentit kur ai person të ketë pranuar njohuri të mjaftueshme se skema është riprodhuar në mënyrë joligjore, ai person mund të ndërmerr çdo veprim në lidhje me rezervat e disponueshme ose me rezervat që janë porositur para atij momenti, me atë që do të detyrohet t'i paguajë mbajtësit të së drejtës një shumë ekuivalente me një kompensim të arsyeshëm, një të tillë që do të duhej t'i paguhej mbi bazën e një marrëveshje licence të arritur lirshëm për atë skemë.

---

[9]Termi "mbartës i së drejtës" në këtë seksion do të kuptohet se ka të njëjtin kuptim si termi "mbajtës i së drejtës" në Traktatin IPIC.

2. Kushtet e vendosura në nënparagrafet (a) deri në (k) të nenit 31 do të zbatohen mutatis mutandis në rast të çdo licencimi jovullnetar për skemën ose për përdorimin e saj nga ana e Qeverisë ose për Qeverinë pa autorizimin e mmbajtësit të të drejtës.

*Neni 38*

*Kohëzgjatja e mbrojtjes*

1. Në vendet anëtare ku kërkojnë regjistrimin si kusht mbrojtje, afati i mbrojtjes së skemës nuk do të përfundojë para skadimit të periudhës prej 10 vitesh të llogaritur prej datës së parashtrimit të kërkesës për regjistrim ose nga shfrytëzimi i parë komercial në cilëndo pjesë të botës.

2. Në vendet anëtare, ku mbrojtja nuk është e kushtëzuar me regjistrim, skemat do të mbrohen në afat prej së paku 10 vitesh pas datës së shfrytëzimit të parë komercial në cilëndo pjesë të botës.

3. Me përjashtim të paragrafëve 1 dhe 2, vendet anëtare mund të mundësojnë që mbrojtja të përfundojë 15 vite pas krijimit të skemës.

SEKSIONI 7: MBROJTJA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

*Neni 39*

1. Gjatë sigurimit të mbrojtjes efektive nga konkurrenca jolojale, të paraparë me nenin 10 të Konventës së Parisit (1967), vendet anëtare do t'i mbrojnë informacionin e pazbuluar në pajtueshmëri me paragrafin 2, ndërsa të dhënat e dorëzuara në Qeveri ose organet shtetërore në pajtueshmëri me paragrafin 3.

2. Personat fizik dhe juridik do të kenë mundësi të parandalojnë të dhënat që sipas ligjit janë në pronësi të tyre, të zbulohen për të tjerët, të përfitohen nga të tjerë ose të përdoren nga të tjerë, pa pëlqimin e tyre dhe në mënyrë të kundërt me praktikat e drejta komerciale, me kusht që të dhënat e tilla:

(a) të jenë sekrete, në esencë se, si tërësi ose sipas konfiguracionit të tyre të saktë dhe përmbledhjes së komponentëve, nuk janë gjerësisht të njohura, ose lehtësisht në dispozicion, nga persona në qarqet që zakonisht marren me atë lloj informacioni;
(b) kanë vlerë komerciale meqenëse janë sekrete (fshehtësi); dhe
(c) janë lëndë e masave të arsyeshme që në rrethana të caktuara i ndërmerr personi që ka kontroll ligjor mbi të dhënat, për të mbajtur fshehtësinë e tyre.

3. Vendet anëtare, në raste kur kërkojnë, si kusht për miratimin për futje në treg të produkteve farmaceutike apo kimike bujqësore që përmbajnë përbërës të ri kimik, që të dorëzohen të dhëna të pazbuluara për teste apo të dhëna të tjera, që mund të sigurohen vetëm me angazhim të madh, përveç në rastet kur zbulimi i tyre është i domosdoshëm për të mbrojtur publikun, ose kur ndërmerren masa me të cilat është siguruar që të dhënat e tilla janë të mbrojtura nga përdorimi të padrejtë komercial.

---

[10]Për qëllimin e kësaj dispozite, "mënyrë në kundërshtim me praktikat e ndershme tregtare" do të thotë të paktën praktika të tilla si shkelja e kontratës, shkelja e besimit dhe nxitja për shkelje, dhe përfshin marrjen e informacionit të pazbuluar nga palë të treta që e dinin ose ishin tejet neglizhent për të mos ditur se praktika të tilla ishin të përfshira në blerje.

## SEKSIONI 8: KONTROLLI I PRAKTIKAVE KUNDËR KONKURRENCËS NË LICENCAT KONTRAKTUALE

*Neni 40*

1. Vendet anëtare pajtohen se disa mënyra të dhënies së licencave, ose kushte që dominojnë në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale, të cilat e kufizojnë konkurrencën, mund të ndikojnë negativisht mbi tregtinë dhe mund të parandalojnë transferin dhe zgjerimin e teknologjisë.
2. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do t'i ndalojë vendet anëtare të specifikojnë në ligjet e tyre mënyrat apo kushtet e dhënies së të drejtave të pronësisë intelektuale që shkaktojnë pasoja negative për konkurrencën në tregun adekuat. Siç është parashikuar më lartë, vendi anëtar mund, në pajtim me dispozitat tjera të kësaj Marrëveshje, të miratoj masa adekuate për parandalimin ose për kontrollin e praktikave të tilla, midis së cilave mund të jenë për shembull, kushte ekskluzive për kthimin e së drejtës, kushte që ndalojnë mohimin e plotfuqishmërisë dhe dhënies së detyrueshme të licencave të lidhura, marrë parasysh ligjet dhe rregulloret relevante të atij vendi anëtar.
3. Çdo vend anëtar, me kërkesë, do të hyjë në konsultime me çdo vend tjetër anëtar që ka arsye të besoj se bartësi i së drejtës së pronësisë intelektuale, që është shtetas ose rezident në vendin Anëtar deri te cili është dorëzuar kërkesa për konsultime, ndërmerr veprime me të cilat shkel ligjet dhe rregulloret, në lidhje me lëndën e kësaj nënpjese, anëtarit që kërkon konsultime dhe që dëshiron të sigurohet se do të kryhet harmonizim me legjislacionin e lëndës, pa dëm sipas cilësdo masë në bazë të ligjit dhe pas lirisë së plotë në lidhje me vendimin përfundimtar të cilësdo nga dy vendet anëtare. Vendi Anëtar të cilit i dërgohet kërkesa në mënyrë të detajuar dhe me qëllim të mirë do të shqyrtojë mundësitë për konsultime dhe do të siguroj mundësi adekuate për konsultime me vendin anëtarë që ka dërguar kërkesën, dhe plotësisht do të bashkëpunojë me të dhe do t'i sigurojë informacione që janë në dispozicion për publikun, e që janë të rëndësishme për çështjen në fjalë, si edhe informacione të tjera që i janë në dispozicion vendit anëtar, de ndërkohë duke marrë parasysh ligjin vendor dhe marrëveshjet e përbashkëta të nënshkruara në lidhje me mbrojtjen e besueshmërisë së atyre të dhënave nga ana e vendit anëtar që parashtron kërkesën për konsultime.
4. Me kërkesë, vendit anëtarë shtetasit po rezidentët e të cilit janë subjekt i masës procedimit ligjore në një vend tjetër anëtar në lidhje me shkeljen e pretenduar të ligjeve dhe rregulloreve të atij vendi anëtar për çështjen e lëndës së kësaj nëpjese, vendit tjetër anëtar do të ofroj mundësinë për konsultime nën kushtet e njëjta si ato të parashikuara në paragrafin 3.

# PJESA III

# ZBATIMI I SË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE

## SEKSIONI 1: DETYRIMET E PËRGJITHSHME

### *Neni 41*

1. Vendet anëtare do të sigurojnë procedurat për zbatimin e të drejtave siç janë të përcaktuara në këtë Pjesë, të jenë të disponueshme në ligjet e tyre për të mundësuar veprime efektive kundër çdo veprimi të shkeljes së të drejtave të pronësisë intelektuale të përfshira në këtë Marrëveshje, duke përfshirë mjete ligjore efikase për parandalimin e shkeljeve dhe mjete ligjore që parandalojnë kryerjen e mëtutjeshme të shkeljeve. Këto procedura do të zbatohen në mënyrë që do të shmanget krijimi i pengesave për tregti ligjore dhe do të sigurojë masa mbrojtëse kundër keqpërdorimeve të tyre.
2. Procedurat që kanë të bëjnë me zbatimin e së drejtës së pronësisë intelektuale do të jenë të paanshme dhe të drejta. Ato nuk do të jenë të komplikuara apo të shtrenjta pa qenë e nevojshme, e as do të kërkojnë caktime të afateve joreale, e as vonesa të panevojshme.
3. Vendimet për faktet e një rasti të dhënë preferohet të jenë në formë të shkruar dhe me arsyetime. Ato do t'u jepen për shqyrtim të paktën palëve në procedurë pa vonesa të panevojshme. Vendimet për faktet e një rasti të caktuar do të bazohen vetëm në dëshmitë për të cilat palëve iu është mundësuar të deklarohen.
4. Palët në procedurë do të kenë mundësinë për rishikim nga ana e organeve gjyqësore të vendimeve përfundimtare administrative dhe, duke marrë parasysh dispozitat për juridiksionin në ligjin e vendit anëtarë në lidhje me rëndësinë e rastit, të paktën edhe të aspekteve juridike të vendimeve fillestare gjyqësore për faktet e rastit të caktuar. Megjithatë, nuk ekziston detyrimi për të siguruar mundësi për rishikim të vendimeve të pafajësisë në rastet penale.
5. Nënkuptohet se kjo Pjesë nuk krijon asnjë detyrim për të futur sistem gjyqësor për zbatimin e së drejtës së pronësisë intelektuale që do të dallonte nga sistemi për zbatimin e ligjeve në përgjithësi, dhe se nuk do të ndikojë mbi aftësinë e vendeve anëtare për të zbatuar ligjet e tyre në përgjithësi. Asgjë në këtë pjesë nuk krijon deytrim në lidhje me shpërndarjen e mjeteve midis zbatimit të së drejtave të pronësisë intelektuale dhe zbatimit të ligjeve në përgjithësi.

## SEKSIONI 2: PROCEDURAT CIVILE DHE ADMINISTRATIVE DHE MJETET JURIDIKE

### *Neni 42*

### *Procedurat e paanshme dhe të drejta*

Vendet anëtare do t'ua mundësojnë mmbajtësve tësë drejtave11 procedurat civile gjyqësore në lidhje me zbatueshmërinë e çdo të drejte të pronësisë intelektuale të përfshirë në këtë Marrëveshje. Pala e paditur gëzon të drejtën për njoftim me shkrim që do të dorëzohet në kohë dhe do të përmbajë detaje të mjaftueshme, përfshirë edhe arsyet mbi të cilat bazohet padia. Palët mund të përfaqësohen nga përfaqësues të pavarur ligjor, ndërsa procedurat nuk do të imponojnë kërkesa të rënda në lidhje me paraqitjen e detyrueshme personale. Të gjitha palët në këto procedura kanë të drejta të arsyetojnë pretendimet e tyre dhe të paraqesin të gjitha dëshmitë relevante. Procedura do të sigurojë mënyra për të vërtetuar dhe mbrojtur të dhëna të besueshme, përveç në rastet kur kjo do të ishte në kundërshtim me kërkesat ekzistuese kushtetuese.

### *Neni 43*

### *Dëshmitë*

1. Organet gjyqësore do të kenë autorizimet, në rastet kur njëra nga palët do të paraqesë dëshmi të arsyeshme të disponueshme që janë të mjaftueshme për të argumentuar pretendimet e saj, dhe kur nxjerr në pah dëshmi që janë të rëndësishme për mbështetjen e pretendimeve, ndërsa janë nën kontrollin e palës kundërshtare, për të urdhëruar atë dëshmi ta paraqesë pala e kundërt, në të tilla situata kur, në raste të caktuara, janë plotësuar kushtet që sigurojnë mbrojtjen e informacioneve të besueshme.
2. Në rastet kur njëra palë në procedurë vullnetarisht dhe pa një arsye të justifikueshme refuzon të lejoj qasje në to, ose në një mënyrë tjetër nuk i siguron informacionet e nevojshme në periudhë të arsyeshme kohore, ose pengon ndjeshëm një procedurë në lidhje me një veprim përmbarimor, vendi anëtar mund të autorizojë organet gjyqësore të marrë vendime paraprake dhe përfundimtare, në favor apo kundër, në bazë të informacioneve që i janë paraqitur, duke përfshirë ankesat apo pretendimet e paraqitura nga pala e prekur me refuzimin në qasjen në informacion, subjekt për t'u ofruar palëve një mundësi për t'u dëgjuar për pretendimet ose provat.

### *Neni 44*

### *Ndalesat gjyqësore*

1. Organet gjyqësore do të kenë autorizime të urdhërojnë palën që të ndalojë me kryerjen e një shkelje të së drejtës, ndër të tjera për të penguar hyrjen në rrjedhën e tregtisë, në territorin e juridiksionit të tyre, të mallrave me të cilat shkelet një e drejtë e pronës intelektuale, menjëherë pas doganimit të atij malli. Vendet anëtare nuk janë të detyruara të japin këto lloj autorizimesh në lidhje me lëndën e mbrojtur që një person e ka arritur apo ka porositur para se të dijë ose para se të ketë baza të arsyeshme se tregtia me atë lëndë do të përfaqësonte shkeljen e ndonjë të drejte të pronësisë intelektuale.

2. Me përjashtim të dispozitave të tjera të kësaj pjese dhe me kusht të respektohen dispozitat e pjesës II, që në mënyrë specifike kanë të bëjnë me përdorimin nga ana e qeverive ose nga palët e treta të autorizuara nga ndonjë qeveri, e pa autorizime nga bartësi i së drejtës, vendet anëtare mund të kufizojnë mjetet juridike në dispozicion kundër përdorimit të tillë përmes Faqesës së kompensimit sipas nënparagrafit (h) të nenit 31. Në raste të tjera, do të zbatohen mjetet juridike sipas kësaj pjese ose, në raste kur këto mjete juridike nuk janë në pajtueshmëri me ligjin kombëtar të vendit anëtar, do të jenë në dispozicion aktgjykimet deklarative dhe kompensimet adekuatet

---

[11] Për qëllimin e kësaj pjese, termi "mbajtës i së drejtës" përfshin federatat dhe shoqatat që kanë status ligjor për të kërkuar të drejta të tilla.

*Neni 45*

*Dëmshpërblimet*

1. Organet gjyqësore do të jenë të autorizuara të urdhërojnë shkelësin që t'i paguajë mmbajtësit të së drejtës dëmshpërblim që do të përfaqësojë dëmshpërblim adekuat për dëmin që i është shkaktuar mmbajtësit të së drejtës me shkeljen e së drejtës së tij të pronësisë intelektuale të kryer nga ana e shkelësit që ka kryer veprime të shkeljes së të drejtës me vetëdije, ose me baza të arsyeshme për të qenë i vetëdijshëm se po kryen shkelje.

2. Organet gjyqësore, gjithashtu, do të kenë autoritetin që të urdhërojnë shkelësin të paguaj shpenzimet e mmbajtësit të së drejtës, të cilat mund të përfshijnë tarifat përkatëse për përfaqësuesin ligjor (avokat). Në raste të caktuara, vendet anëtare mund të autorizojnë organet gjyqësore të urdhërojnë rikuperimin e fitimeve dhe / ose Faqesën e dëmit paraprakisht të përcaktuar, madje edhe në rastet kur shkelësi ka marrë pjesë në këto veprime pa vetëdije apo pa baza të arsyeshme për të qenë i vetëdijshëm se po kryen shkelje.

*Neni 46*

*Mjetet e tjera juridike*

Për të siguruar parandalim efikas ndaj shkeljeve të të drejtave, organet gjyqësore do të kenë autoritetin të urdhërojnë që mallrat për të cilat është përcaktuar se përfaqësojnë shkelje të të drejtave, pa asnjë lloj kompensimi, të tërhiqen nga qarkullimi tregtar në atë mënyrë që do të shmanget çdo dëmtim për mmbajtësin e të drejtës ose, nëse kjo nuk është në kundërshtime me kërkesat ekzistuese kushtetuese, të shkatërrohen. Organet gjyqësore gjithashtu do të kenë autoritetin për të urdhëruar që lëndët e para dhe pajisjet të cilat kryesisht janë përdorur për krijimin e mallit me të cilin kryhet shkelja e së drejtës, pa asnjë dëmshperblim të tërhiqen nga qarkullimi tregtar në mënyrë të tillë për të minimizuar rrezikun e shkeljeve të mëtejeshme. Gjatë shqyrtimit të këtyre kërkesave, do të merret parasysh proporcioni midis seriozitetit të shkeljes dhe mjeteve të ndërmarra juridike, si edhe interesat e palëve të treta. Në lidhje me mallrat me markë tregtare të falsifikuara, nuk do të jetë e mjaftueshme vetëm të largohet marka tregtare e vënë në mënyrë joligjore, përveç në raste specifike, për të lejuar qarkullimin e mallit në treg.

*Neni 47*

*E drejta e informimit*

Vendet anëtare mund të sigurojnë që organet gjyqësore të kenë autoritetin, përveç rasteve kur kjo do të ishte jashtë proporcionit me seriozitetin e shkeljes, për të urdhëruar shkelësit që të informojnë mmbajtësin e së drejtës për identitetin e palëve të treta të përfshira në prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave dhe shërbimeve me të cilat kryhet shkelja e të drejtave, dhe për kanalet e tyre të shpërndarjes.

*Neni 48*

*Dëmshpërblimi i të paditurit*

1. Organet gjyqësore kanë autoritetin të urdhërojnë palën, me kërkesë të së cilës janë ndërmarrë masat dhe ka shkelur procedurat për zbatimin e së drejtës, që të i sigurojë palës, së cilës padrejtësisht i është caktuar ndalesë apo kufizim, një kompensim adekuat për dëmin e shkaktuar si pasojë e keqpërdorimit të tillë. Organet gjyqësore, gjithashtu, kanë autoritetin të urdhërojnë kërkuesin t'i paguajë shpenzimet personit të paditur, të cilat mund të përfshijnë honorarët përkatëse të përfaqësuesve ligjor (avokatëve).

2. Në lidhje me zbatueshmërinë e çdo ligj që ka të bëjë me mbrojtjen apo zbatimin e së drejtës së pronësisë intelektuale, vendet anëtare do t'i lirojnë organet publike dhe nëpunësit publik nga obligimi për të siguruar mjete përkatës juridike, vetëm në rastet kur veprimet gjatë zbatimit të atyre ligjeve janë ndërmarrë apo planifikuar me qëllim të mirë.

*Neni 49*

*Procedurat administrative*

Në rast se çdo mjet civil ligjor mund të urdhërohet si rezultat i procedurës administrative në lidhje me faktet me një rast të caktuar, procedura e tillë duhet të jetë në përputhje me parimet të cilat në thelb janë ekuivalentë të atyre të përcaktuara në këtë Seksion.

## SEKSIONI 3: MASAT E PËRKOHSHME

*Neni 50*

1. Organet gjyqësore kanë autoritetin të urdhërojnë ndërmarrjen e masave të përkohshme të shpejta dhe efikase:

(a) për të parandaluar paraqitjen e shkeljes e çdo të drejte të pronësisë intelektuale, e sidomos për të parandaluar futjen e mallrave të caktuar në qarkullim tregtar nën juridiksionin e tyre, duke përfshirë edhe mallrat e importuar menjëherë pas doganimit;
(b) për të ruajtur dëshmi të rëndësishme për shkeljen e pretenduar.

2. Organet gjyqësore kanë autoritetin në raste të caktuara të miratojnë masa të përkohshme inaudita letra parte, sidomos në ato raste kur çdo vonesë mund të shkaktojë dëm të pandreqshëm të mmbajtësit të së drejtës, ose kur ekziston rrezik i provueshëm nga shkatërrimi i provave.

3. Organet gjyqësore kanë autoritetin të kërkojnë nga paditësi të vendosë të gjitha provat e arsyeshme në dispozicion për të siguruar me një shkallë të kënaqshme të sigurisë se paditësi është mbartësi i vërtetë i së drejtës dhe se janë shkelur të drejtat e tij, ose se ekziston rrezik i menjëhershëm për t'u shkelur ato, si edhe t'i urdhërojnë paditësit që të jap sigurim ose garanci ekuivalente në masë të mjaftueshme për të mbrojtur palën e paditur dhe për të parandaluar keqpërdorimin.

4. Në rastet e miratimit të masave të përkohshme inaudita altera parte, palët e prekura do të njoftohen pa vonesa për atë, pas zbatimit të masave. Rishikimi, përfshirë të drejtën për t'u deklaruar, do të kryhet me kërkesë të palës së paditur me qëllim që të meret vendim, në afat të arsyeshëm pas njoftimit të masave, pa marrë parasysh se këto masa do të ndryshojnë, tërhiqen apo pranohen.

5. Nga paditësi mund të kërkohet të ofrojë informacione të tjera të domosdoshme për identifikimin e mallit për të cilin bëhet fjalë, nga organet që do të kryejnë masat e përkohshme.

6. Pa cenuar paragrafin 4, masat e përkohshme të ndërmarra në bazë të paragrafëve 1 dhe 2, me kërkesë të palës së paditur, do të tërhiqen (revokohen) ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndalojnë të vlejnë, nëse procedura gjyqësore që çon në sjelljen e vendimit për rëndësinë e rastit nuk është iniciuar në periudhë të arsyeshme, që do të përcaktohet nga organi gjyqësor që ka urdhëruar masat në rastet kur këtë e lejon ligji i vendit anëtarë, ose, në mungesë të një përkufizimi të tillë, do të revokohen ose do të ndalojnë të vlejnë në afat që nuk është më i gjatë se 20 ditë pune, ose 31 ditë kalendarike, cilido qoftë afat më i gjatë.

7. Në rastet kur masat e përkohshme do të tërhiqen (revokohen) ose të vjetërsohen si pasojë e ndonjë veprimi apo mosveprimi i paditësit, ose kur më pas përcaktohet se nuk ka pasur shkelje apo rrezik për paraqitje të shkeljeve të së drejtës së pronësisë intelektuale, organet gjyqësore kanë autoritetin të urdhërojnë paditësin, me kërkesë të palës së paditur, t'i sigurojë palës së paditur kompensimin e duhur për dëmin eventual të shkaktuar me masat e përkohshme.

8. Në rast se ndonjë masë e përkohshme mund të urdhërohet si rezultat i procedurave administrative në lidhje me rëndësinë e rastit të caktuar, këto procedura duhet të jenë në përputhje me parimet të cilat në thelb janë ekuivalente me ato të përmendura në këtë nënpjesë.

## SEKSIONI 4: KËRKESA TË VEÇANTA TË LIDHURA ME MASAT KUFITARE [12]

### *Neni 51*

### *Pezullimi i qarkullimit nga Autoritete Doganore*

Vendet anëtare, në pajtim me dispozitat e mëposhtme, do të miratojnë procedura me të cilat do t'i mundësojnë mmbajtësit të së drejtës, i cili ka arsye për të dyshuar se mund të bëhet importimi i mallit me markë tregtare të falsifikuar ose mallit të prodhuar në bazë të të përvetësimit të paligjshëm të veprave autoriale, për të paraqitur një kërkesë me shkrim pranë organeve përkatëse administrative apo gjyqësore për të urdhëruar autoritetet doganore të shtyjnë qarkullimin në treg të atij malli. Vendet anëtare mund të mundësojnë që kjo kërkesë të dorëzohet edhe në lidhje me mallrat tek të cilët bëhet fjalë për lloje të tjera të shkeljes së të drejtave të pronësisë intelektuale, me kusht që të plotësohen kërkesat nga ky Seksion. Vendet anëtare mundet gjithashtu të parashikojnë procedura adekuate për pezullimin nga ana e organeve doganore të futjes në qarkullim të mallrave me të cilat kryhet shkelja, e të cilët janë të destinuara për eksport nga territoret e tyren.

---

[12] Kur një vend Anëtar ka shpërbërë në thelb të gjitha kontrollet mbi lëvizjen e mallrave përtej kufirit të tij me një vend anëtar tjetër me të cilin është pjesë e një bashkimi doganor, nuk do t'i kërkohet të zbatojë dispozitat e këtij seksioni në atë kufi.

[13] Kuptohet se nuk do të ketë asnjë detyrim për të zbatuar procedura të tilla për importet e mallrave të vendosura në treg në një vend tjetër nga ose me pëlqimin e titullarit të së drejtës, ose për mallrat në tranzit.

[14] Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

(a) "mallra të falsifikuara të markës tregtare" do të thotë çdo mall, duke përfshirë paketimin, që mban pa autorizim një markë tregtare e cila është identike me markën e regjistruar në mënyrë të vlefshme në lidhje me këto mallra, ose që nuk mund të dallohet në aspektet e saj thelbësore nga një markë e tillë tregtare, dhe që në këtë mënyrë cenon të drejtat e pronarit të markës në fjalë sipas ligjit të vendit të importimit;

(b) "mallra pirate të së drejtës së autorit" do të thotë çdo mall që është kopje e bërë pa pëlqimin e mbajtësit të së drejtës ose personit të autorizuar rregullisht nga mbajtësi i së drejtës në vendin e prodhimit dhe që janë bërë drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një artikull ku krijimi i asaj kopjeje do të ketë përbërë shkelje të një të drejte autori ose të një të drejte të lidhur sipas ligjit të vendit të importimit.

*Neni 52*

*Padia*

Çdo mbartës i së drejtës që inicion procedurë në bazë të nenit 51, do të jetë i obliguar të paraqesë dëshmi që do t'i bindin organet përkatëse se, në pajtim me ligjet e vendit për importet, ekziston prima facie shkelje e së drejtës së pronësisë intelektuale të mbajtësit të së drejtës, dhe të paraqesë përshkrim mjaftueshëm të detajuar të mallrave që do t'i mundësojë organeve doganore lehtësisht të njohin ato. Organet kompetente në afat të arsyeshëm do të njoftojnë parashtruesin e padisë se a e kanë pranuar kërkesën për inicim të procedurës dhe, në rastet kur organet kompetente e përcaktojnë, për periudhën për të cilën organet doganore do të ndërmarrin masat adekuate.

*Neni 53*

*Siguria ose garancia ekuivalente*

1. Organet kompetente do të kenë autoritetin për t'i kërkuar një aplikanti të sigurojë një kolateral ose garanci ekuivalente që do të jetë e mjaftueshme për të mbrojtur të padituri dhe organet kompetente dhe për të parandaluar abuzimin. Një siguri e tillë ose garanci ekuivalente nuk do të pengojë në mënyrë të paarsyeshme rekursin ndaj këtyre procedurave.

2. Në rastet kur në pajtim me ndonjë kërkesë të parashtruar në bazë të dispozitave të ktij Seksioni lëshimi në qarkullim i mallit që përfshinë dizenjo industrial, patenta, skema të qarqeve të integruara apo informacione të besueshme është pezulluar nga autoritetet doganore me vendim që nuk është vendim i organit gjyqësor apo organi tjetër të pavarur, ndërsa afati i parashikuar ne nenin 55 ka përfunduar pa dhënien e lirim të përkohshëm të mallit nga organi i autorizuar, dhe me kusht të jenë plotësuar të gjitha kushtet e tjera për import, pronari, importuesi apo pranuesi i mallit në fjalë do të ketë të drejtën ta lëshoj në qarkullim pasi të paguajë kolateral (garanci) në shumë të mjaftueshme për të mbrojtur mmbajtësin e së drejtës nga çdo shkelje. Faqesa e kësaj garancie nuk do të jetë në dëm për asnjë mjeti tjetër juridik që i është vendosur në dispozicion mmbajtësit të së drejtës, duke nënkuptuar se garancia do të kthehet nëse mbartësi i së drejtës nuk e shfrytëzon të drejtën e vet për të ngritur padi në afatin e caktuar kohor.

*Neni 54*

*Njoftimi për pezullimin*

Importuesi dhe aplikanti do të njoftohen menjëherë për pezullimin e lëshimit në qarkullim të mallrave në bazë të nenit 51.

*Neni 55*

*Kohëzgjatja e pezullimit*

Nëse, në afat jo më të gjatë se 10 ditë pune pasi aplikantit i është dërguar njoftimi për pezullimin, autoritetet doganore nuk janë njoftuar se ndonjëra palë që nuk është palë e paditur ka iniciuar procedurë për sjellje të vendimit në lidhje me rëndësinë e rastit, ose se organi i autorizuar me rregull ka ndërmarrë masa të parakohshme me të cilat vazhdohet pezullimi i futjes në qarkullim të mallrave, malli do të futet në qarkullim, me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kushtet tjera për import dhe eksport; në raste të caktuara, ky afat mund të vazhdohet edhe për 10 ditë pune shtesë. Nëse është nisur procedurë që duhet të sjellë deri tek vendimi për rëndësinë e rastit të dhënë, në kërkesën e të paditurit do të bëhet rishikim, nën të cilën nënkuptohet edhe e drejta për t'u deklaruar, me qëllim që në afat të arsyeshëm të sillet vendim mbi atë se ato masa do të ndryshojnë, tërhiqen (revokohen) apo konfirmohen. Me përjashtim të të lartpërmendurës, në raste kur pezullimi i lëshimit në qarkullim kryhet ose vazhdohet në pajtim me ndonjë masë të përkohshme gjyqësore, do të zbatohen dispozitat e paragrafit 6 të nenit 50.

*Neni 56*

*Dëmshpërblimi i importuesit dhe pronarit të mallrave*

Organet kompetente do të jenë të autorizuara të urdhërojnë parashtruesin e kërkesës t'i paguaj importuesit, pranuesit të mallit dhe pronarit të mallit, kompensim adekuat për çfarëdo dëmi që u është shkaktuar përmes mbajtjes së padrejtë të mallit apo përmes mbajtjes së mallit të lëshuar në qarkullim në bazë të nenit 55.

*Neni 57*

*E drejta për inspektim dhe informim*

Pa shkelje të mbrojtjes së të dhënave të besueshme, vendet anëtare do të autorizojnë organet kompetente që t'i japin mmbajtësit të së drejtës mundësi të mjaftueshme për të siguruar inspektim të çdo produkti që është ndaluar (mbajtur) nga organet doganore, për të mbështetur kërkesat e veta si mbartës i së drejtës. Organet kompetente gjithashtu do të jenë të autorizuara që edhe importuesit t'i japin mundësinë e barabartë të sigurojë inspektim të mallit. Në rastet kur është sjellë vendim afirmativ për rëndësinë e rastit, vendet anëtare mund të autorizojnë organet kompetente për të njoftuar mbajtësin e së drejtës për emrat dhe adresat e dërguesit të mallit, të importuesit dhe të pranuesit të mallit, si edhe për sasinë e mallit për të cilin bëhet fjalë.

*Neni 58*

*Veprimet Ex officio*

Në rastet kur vendet anëtare kërkojnë nga organet kompetente të veprojnë sipas detyrës zyrtare dhe të pezullojnë lëshimin në qarkullim të mallrave për të cilat janë siguruar prima facie dëshmi se janë shkelur të drejta të pronësisë intelektuale:

(a) organet kompetente mund në çfarëdo kohe të kërkojnë nga mbartësi i së drejtës të dhëna që mund t'u vijnë në ndihmë gjatë ushtrimit të autorizimeve;

(b) importuesi dhe mbartësi i së drejtës menjëherë do të njoftohen për pezullimin. Në rastet kur importuesi ka dorëzuar deri tek organet ankesë kundër pezullimit, pezullimi do t'i nënshtrohet kushteve mutatis mutandis, të nenit 55;

(c) Vendet anëtare do t'i lirojnë organet publike dhe nëpunësit e tyre nga përgjegjësia për të ndërmarrë masa adekuate juridike vetëm në rastet kur veprimet ndërmerren ose planifikohen me qëllim të mirë.

*Neni 59*

*Mjetet juridike*

Pa shkeljen e të drejtave të tjera të veprimeve që i ka në dispozicion mbartësi i së drejtës, dhe me kusht të plotësimit të së drejtës së të padituritë kërkojë rishikim nga ana e organit gjyqësor, organet kompetente do të jenë të autorizuara të urdhërojnë shkatërrimin ose asgjësimin e mallit me të cilin kryhet shkelja, në pajtim me parimet e thëna në nenin 46. Në lidhje me mallin e falsifikuar me markë tregtare, organet kompetente nuk do të lejojnë rieksportimin në gjendjen e pandryshuar të mallrave me të cilat kryhet shkelja e të drejtave, e as që do të nënshtrohen në procedura tjera doganore, përveç në rrethana të jashtëzakonshme.

*Neni 60*

*Importet De minimis*

Vendet anëtare mund të përjashtojnë nga zbatimi i dispozitave të lartpërmendura sasi të vogla të mallrave të natyrës jokomerciale të përfshira në bagazhet personale të udhëtarëve ose që janë dërguar në dërgesa më të vogla.

## SEKSIONI 5: PROCEDURAT PENALE

*Neni 61*

Vendet anëtare do të parashikojnë procedura penale dhe dënime që do të zbatohen të paktën në rast të falsifikimit të vetëdijshëm të markës tregtare ose të piraterisë së të drejtave autoriale të kryera për qëllime tregëtare. Mjetet juridike në dispozicion do të përfshijnë dënim me burgim dhe / ose dënime në para që do të jenë mjaftueshëm të larta që të shërbejnë si masa parandaluese, në përputhje me nivelin e dënimeve që zbatohen për vepra penale me rëndësi të njëjtë. Në rastet adekuate, mjetet juridike në dispozicion do të përfshijnë gjithashtu sekuestrimin, konfiskimin dhe shkatërrimin e mallit me të cilin është kryer shkelja dhe i të gjithë materialeve (lëndëve të para) dhe pajisjeve që janë përdorur për kryerjen e veprës penale. Vendet anëtare mund të parashikojnë që procedurat penale dhe dënimet të zbatohen edhe në raste të tjera të shkeljes së të drejtës së pronësisë intelektuale, sidomos kur shkeljet kryhen me vetëdije dhe me qëllime komerciale.

## PJESA IV

## FITIMI DHE MBAJTJA E SË DREJTËS SË PRONËSISË INTELEKTUALE DHE PROCEDURAT ADEKUATE INTER-PARTES (MIDIS PALËVE)

### *Neni 62*

1. Vendet anëtare mund të kërkojnë, si kusht për arritjen apo mbajtjen (ruajtjen) e së drejtës së pronësisë intelektuale të parashikuara në Seksionet 2 deri 6 të pjesës së II-të, respektimin e procedurave dhe formalitete të arsyeshme. Procedurat dhe formalitetet e tilla do të jenë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Në rastet kur fitimi i së drejtës së pronësisë intelektuale është i kushtëzuar me dhënie apo regjistrim të së drejtës, vendet anëtare do të sigurojnë që procedurat për dhënien apo regjistrim, në përputhje me kushtet bazike për fitimin e së drejtës, të mundësojnë dhënien apo regjistrimin e së drejtës brenda një periudhe të arsyeshme kohore në mënyrë që të shmanget shkurtimi i panevojshëm i periudhës së mbrojtjes.

3. Neni 4 i Konventës së Parisit (1967) do të zbatohet mutatis mutandis për markat tregtare të shërbimeve.

4. Procedurat për fitimin ose mbajtjen e së drejtës së pronësisë intelektuale dhe, kur ligji kombëtar parashikon procedura të tilla, revokimi (anulimi) në procedurën administrative dhe inter partes procedurat siç janë kundërshtimi, revokimi dhe anulimi, do të udhëhiqen nga parimet e përgjithshme të përcaktuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 41.

5. Vendimet përfundimtare administrative në secilën nga procedurat për të cilat flitet në paragrafin 4, do t'i nënshtrohen rishikimit nga organe gjyqësore ose nga organe kompetente të organeve gjyqësore. Megjithatë, nuk do të ekzistojnë detyrime për të siguruar mundësi për rishikim të tillë të vendimeve në rastet e kundërshtimit jo të suksesshëm apo të revokimit administrativ, me kusht që arsyet për këto procedura të mund të jenë objekt i procedurave për shpalljen e tyre si të pavlefshme.

## PJESA V

## PARANDALIMI DHE ZGJIDHJA E MOSMARËVESHJEVE

### *Neni 63*

### *Transparenca*

1. Ligjet dhe rregulloret, vendimet përfundimtare gjyqësore dhe vendimet administrative me zbatim të përgjithshëm, të zbatuara nga ndonjë vend anëtar në lidhje me objektin e kësaj marrëveshje (disponueshmëria, qëllimi, fitimi (përvetësimi), zbatimi dhe parandalimi i keqpërdorimit të së drejtës së pronësisë intelektuale), do të publikohen ose, në rastet kur publikimi nuk do të jetë i mundur, do të vendoset në dispozicion për publikun në gjuhën kombëtare, në mënyrë që do t'u mundësojë qeverive dhe mmbajtësve tëtë drejtave që të njihen me to. Marrëveshjet që kanë të bëjnë me objektin e kësaj Marrëveshje, që janë në fuqi midis qeverisë apo agjencisë qeveritare të ndonjë vendi anëtarë dhe qeverisë dhe agjencisë qeveritare të ndonjë shteti tjetër anëtarë, gjithashtu do të publikohen.

2. Vendet anëtare do të dorëzojnë deri te Këshilli TRIPS njoftim për ligjet dhe rregulloret e përmendura në paragrafin 1, për të ndihmuar Këshillin gjatë rishikimit të funksionimit të kësaj marrëveshjeje. Këshilli do të përpiqet të minimizojë barrën e vendeve anëtare gjatë përmbushjes së këtij detyrimi dhe mund të vendosë të tërheq detyrimin për të njoftuar drejtpërdrejtë tek Këshilli këto ligje dhe rregullore nëse janë të suksesshme bisedimet me WIPO për themelimin e regjistrit të përbashkët i cili do të përmbante këto ligje dhe rregullore. Në lidhje me këtë, Këshilli do të shqyrtojë edhe mundësitë për veprime eventuale që do të ishin të nevojshme për njoftimet në përputhje me detyrimet në bazë të kësaj marrëveshje, që dalin nga dispozitat e nenit 6 ter të Konventës së Parisit (1967).

3. Çdo vend anëtar do të jetë i përgatitur për të dhënë, në përgjigje të kërkesës me shkrim nga ndonjë vend tjetër anëtar, informacione të llojit për të cilët flitet në paragrafin 1. Vendi anëtarë që ka arsye të besoj se vendim konkret gjyqësor apo vendimi administrativ apo marrëveshja dypalëshe në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale i prek të drejtat e saj në bazë të kësaj marrëveshje, mund gjithashtu të kërkoj në formë të shkruar që t'i mundësojë qasje ose të informohet mjaftueshëm në detaje për vendimet gjyqësore ose vendimet administrative ose marrëveshjet dypalëshe

4. Asgjë në paragrafet 1 deri 3 nuk detyron vendet anëtare të zbulojnë të dhëna të besueshme që do të pengonin zbatimin e ligjeve ose në ndonjë mënyrë tjetër të ishin në kundërshtim me interesin publik ose do të dëmtonin interesat legjitime komerciale të ndërmarrjeve të caktuara, publike apo private.

*Neni 64*

*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*

1. Dispozitat e neneve XXII dhe XXIII të GATT të vitit 1994, siç janë përpunuar dhe zbatuar në Marrëveshjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, do të zbatohen gjatë konsultimeve dhe zgjidhjeve të mosmarrëveshjeve sipas kësaj Marrëveshje, përveç nëse është parashikaur ndryshe në këtë marrëveshje.

2. Paragrafët 1 (b) dhe 1 (c) të nenit XXIII të GATT të vitit 1994 nuk do të zbatohen në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në bazë të kësaj Marrëveshje në periudhë prej pesë viteve nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së OBT-së.

3. Gjatë periudhës kohore të përmendur në paragrafin 2, Këshilli TRIPS do të shqyrtojë qëllimin dhe mënyrat për ankesat të llojit të parashikuar në pikat 1(b) dhe 1(c) të nenit XXIII të GATT të vitit 1994, që parashtrohen në bazë të kësaj marrëveshje dhe rekomandimet e saj do t'i dërgojë në Konferencën ministrore për aprovim. Çdo vendim i Konferencës ministrore për të miratuar rekomandime të tilla apo për të zgajtur periudhën nga paragrafi 2, do të meren vetëm me konsensus, ndërsa rekomandimet e miratuara do të jenë efektive për të gjitha vendet anëtare pa ndonjë proces shtesë të miratimit formal.

## PJESA VI

## MARRËVESHJET KALIMTARE

*Neni 65*

*Marrëveshjet kalimtare*

1. Në varësi të dispozitave në paragrafët 2, 3 dhe 4, asnjë vend anëtar nuk do të jetë i detyruar të zbatojë dispozitat e kësaj Marrëveshje para përfundimit të periudhës së përgjithshme prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së OBT-së.

2. Një vend anëtar në zhvillim ka të drejtë të shtyjë për një periudhë prej katër vitesh datën e aplikimit, siç përcaktohet në paragrafin 1, të dispozitave të kësaj marrëveshje, përveç neneve 3, 4 dhe 5.

3. Çdo vend anëtar tjetër që është në proces transformimi nga një ekonomi e planifikuar në qendër drejt ekonomisë së lirë të tregut dhe që ndërmerr reforma strukturore të sistemit të tij të pronësisë intelektuale dhe përballet me problemet e veçanta në përgatitjen dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve për pronësi industriale, mund gjithashtu të përfitojë periudhë shtyrjeje siç parashikohet në paragrafin 2.

4. Në rast se një vend anëtar në zhvillim është i detyruar me këtë marrëveshje të zgjeroj mbrojtjen me patentë të produkteve nga fusha e teknologjisë të cilat nuk janë aq të mbrojtura në territorin e tij, në datën e përgjithshme të zbatimit të kësaj marrëveshje për atë vend anëtar, siç është përcaktuar në paragrafin 2, kjo mund të vonojë(shtyjë) zbatimin e dispozitave për patentat e produkteve të Seksionit 5 të Pjesës II për ato fusha të teknologjisë për periudhë shtesë prej pesë vitesh.

5. Vendi anëtar që përdor periudhë kalimtare sipas paragrafëve 1,2,3 ose 4 do të sigurojë që të gjitha ndryshimet në ligjet, rregulloret dhe praktikat e tij të bëra gjatë asaj periudhe të mos rezultojnë në një shkallë më të vogël përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshje.

*Neni 66*

*Vendet anëtare më pak të zhvilluara*

1. Duke marrë parasysh nevojat dhe kërkesat e veçanta të Vendeve anëtare më pak të zhvilluara, kufizimet e tyre ekonomike, financiare dhe administrative, si dhe nevojën e tyre për fleksibilitet për të krijuar bazë të qëndrueshme teknologjike, këto vende anëtare nuk do të detyrohen të zbatojnë dispozitat e kësaj marrëveshje, përveç neneve 3,4 dhe 5, për një periudhë prej 10 vitesh nga data e zbatimit të përcaktuar në paragrafin 1 neni 65. Këshilli i TRIPS, pas marrjes së kërkesës së arsyetuar mirë nga vendi anëtarë më pak i zhvilluar, do të miratojë vazhdimin e kësaj periudhe.

2. Vendet anëtare më pak të zhvilluara do t'i sigurojnë iniciativa ndërmarrjeve dhe institucioneve në territoret e tyre me qëllim të promovimit dhe nxitjes së transferimit të teknologjisë në vendet anëtare më pak të zhvilluara, në mënyrë që t'i mundësohet atyre që të krijojnë një bazë të qëndrueshme teknologjike.

*Neni 67*

*Bashkëpunimi teknik*

Për të lehtësuar zbatimin e kësaj Marrëveshje, vendet anëtare të zhvilluara do të sigurojnë, me kërkesë dhe nën kushte dhe afate të pranuara bashkërisht, bashkëpunim teknik dhe financiar në favor të vendeve anëtare në zhvillim dhe vendeve anëtare më pak të zhvilluara. Ky bashkëpunim do të përfshijë ndihmë në përgatitjen e legjislacionit për mbrojtjen dhe zbatimin e së drejtës së pronësisë intelektuale, si dhe për parandalimin e keqpërdorimit të tij dhe mbështetje në lidhje me krijimin dhe përforcimin e zyrave dhe agjencive vendase të lidhura me këto çështje, duke përfshirë trajnimet e personelit.

## PJESA VII

## MARRËVESHJET INSTITUCIONALE; DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### *Neni 68*

### *Këshilli për aspektet tregtare të së drejtës së pronësisë intelektuale*

Këshilli për aspektet tregtare të së dretjës së pronësisë intelektuale do të ndjek funksionimin e kësaj Marrëveshje dhe, sidomos, përmbushjen e detyrimeve nga vendet anëtare në bazë të kësaj marrëveshje dhe, do t'u mundësojë vendeve anëtare mundësinë të konsultohen për çështjet në lidhje me aspektet tregtare të së drejtës së pronësisë intelektuale. Ai do të kryej edhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara nga vendet anëtare dhe në veçanti, do të ofrojë ndihmë për ata që do ta kërkojnë në kontekst të procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Gjatë kryerjes së funksioneve të tij, Këshilli për TRIPS mund të konsultohet dhe të kërkojë informacion nga çdo burim që e sheh të përshtatshëm. Në konsultim me WIPO, Këshilli do të kërkojë të vendosë, brenda një viti nga takimi i tij i parë, aranzhimet e duhura për bashkëpunim me organet e asaj Organizate..

### *Neni 69*

### *Bashkëpunimi ndërkombëtar*

Vendet anëtare bien dakord të bashkëpunojnë midis tyre me qëllim që të eliminojnë tregtinë ndërkombëtare me mallra që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale. Për këtë qëllim, ata do të krijojnë dhe njoftojnë pikat e kontaktit në administratat e tyre dhe do të jenë të gatshëm të shkëmbejnë informacione për tregtinë e mallrave për të cilat shkelen të drejtat. Ato, në veçanti, do të nxisin shkëmbimin e informacioneve dhe bashkëpunimin midis autoriteteve doganore në lidhje me tregtinë e mallrave me markë tregtare të falsifikuar dhe me mallra të prodhuara në bazë të veprave autoriale të përfituara në mënyrë joligjore.

### *Neni 70*

### *Mbrojtja e subjekteve ekzistuese të shkeljes*

1. Nga kjo marrëveshje nuk dalin detyrime në lidhje me veprimet që kanë ndodhur para datës së zbatimit të Marrëveshjes për vendin anëtar në fjalë.

2. Me përjashtim të rasteve kur është përcaktuar ndryshe në këtë marrëveshje, kjo marrëveshje krijon detyrime në lidhje me çdo subjekt të shkeljes që ekzsiton në ditën e zbatimit të Marrëveshjes për vendin anëtarë në fjalë, dhe kush është i mbrojtur në atë datë në atë vend anëtar, ose që plotëson apo do të plotësojë në mënyrë plotësuese kriteret për mbrojtje në bazë të dispozitave të kësaj marrëveshje. Në lidhje me këtë paragraf dhe paragrafët 3 dhe 4, detyrimet për të drejtat e autorit që kanë të bëjnë me veprat ekzistuese do të përkufizohen vetëm në bazë të nenit 18 të Konventës së Bernës (1971), ndërsa detyrimet në lidhje me të drejtat e producentëve të fonogrameve dhe performuesve në raport me fonogramet ekzistuese do të përcaktohen vetëm në bazë të nenit 18 të Konventës së Bernës (1971) zbatimi i së cilës është parashikuar në paragrafin 6 të nenit 14 të kësaj marrëveshje.

3. Nuk do të ketë asnjë detyrim për rivendosje të mbrojtjes së subjektit që në datën e zbatimit të kësaj marrëveshje për vendin anëtarë në fjalë, ka hyr në përdorim publik.

4. Në raport me veprimet në lidhje me objektet specifike që përfshijnë subjekte të mbrojtjes së shkelur, që bëhen procedura të shkeljes së të drejtës në bazë të dispozitave ligjore të sjella sipas kësaj marrëveshje, të cilat kanë filluar, ose për të cilat janë kryer investime të rëndësishme, para datës në të cilën ai vend anëtar ka pranuar marrëveshjen me OBT-në, çdo vend anëtarë mund të parashikojë kufizimin e mjeteve juridike për kryerjen e mëtejshme të veprimeve të tilla pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje për atë vend anëtar. Megjithatë, në këto raste, vendet anëtare do të parashikojnë të paktën Faqesën e një shpërblimi të drejtë.

5. Vendi anëtar nuk është i detyruar të zbatojë dispozitat e nenit 11 dhe të paragrafit 4 të nenit 14 në lidhje me origjinalet apo kopjet e blera para datës së zbatimit të kësaj marrëveshje nga ai vend anëtar.

6. Vendi anëtar nuk do të detyrohet të zbatojë nenin 31, ose kërkesat në paragrafin 1 të nenit 27 sipas të cilit të drejtat e patentës mund të ushtrohen pa diskrimin në fushën e teknologjisë, për tu përdorur pa autorizim nga mbartësi i së drejtës në rastet kur autorizimi për përdorimin e tillë është dhënë nga qeveria para shpalljes së datës së kësaj marrëveshje.

7. Në rastin e të drejtave të pronësisë intelektuale mbrojtja e të cilave është e kushtëzuar me regjistrim, kërkesat për mbrojtje që kanë qenë në procedurë në ditën e zbatimit të kësaj marrëveshje për vendin anëtar në fjalë, do të lejohet që të ndryshohen në mënyrë që të mund të kërkohet mbrojtje më e përmirësuar sipas dispozitave të kësaj marrëveshje. Këto ndryshime dhe plotësime nuk do të përfshijnë subjekte të reja.

8. Në rastet kur vendi anëtar, deri në hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së OBT-së, nuk do të vendosë në dispozicion mbrojtjen e patentave për produktet farmaceutike dhe produktet bujqësore kimike në përputhje me detyrimet e saj në bazë të nenit 27, ai vend anëtar:

(a) pa marrë parasysh dispozitat e pjesës VI, nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes me OBT, do të sigurojë një mënyrë se si mund të paraqiten kërkesa për patenta për ato shpikje;

(b) do të zbatojë mbi këto kërkesa, nga data e zbatimit të kësaj marrëveshje, kriteret për përmirësimin e patentave siç është përcaktuar në këtë marrëveshje ose, kur ekziston ose kërkohet pranim i së drejtës së prioritetit, në datën e së drejtës së prioritetit për atë kërkesë; dhe

(c) do të sigurojë mbrojtje të patentës në përputhje me këtë marrëveshje, nga njohja e patentës dhe për periudhën vijuese të vlefshmërisë së patentës, duke llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës në përputhje me nenin 33 të kësaj marrëveshje, për ato kërkesa që plotësojnë kriteret për mbrojtje për të cilat flitet në pikën (b).

9. Në rastet kur një produkt është subjekt i një aplikimi për patentë në ndonjë vend anëtar në përputhje me paragrafin 8 (a), të drejta ekskluzive të marketingut do të jepen pa marrë parasysh dispozitat e pjesës IV, për një periudhë për pesë vitesh pasi në atë vend anëtarë të jetë marrë miratim për futjen e mallit në treg, ose derisa patenta për produktin të pranohet ose refuzohet në atë vend anëtarë, në varësi se cila periudhë është më e shkurtër, me kusht që pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së OBT-së të jetë depozituar aplikimi për patentë dhe të jetë dhënë një patentë për atë produkt në një vend anëtar tjetër, dhe në atë vend anëtar të jetë dhënë miratimi për futje në qarkullim.

*Neni 71*

*Rishikime dhe ndryshime*

1. Këshilli TRIPS do të shqyrtojë zbatimin e kësaj marrëveshje pas përfundimit të periudhës kalimtare për të cilën flitet në paragrafin 2 të nenit 65. Këshilli, duke marrë parasysh përvojën e arritur në zbatimin e saj, do të kryejë rishikim 2 vite pas kësaj date, ndërsa rishikimet e mëtejeshme do t'i kryej në intervale të njëjta kohore. Këshilli mund të ndërmarrë gjithashtu rishikime në raste të ngjarjeve të reja që mund të kërkojnë nevojën për ndryshim apo plotësim të kësaj marrëveshje.

2. Ndryshimet që shërbejnë vetëm për qëllime të përshtatshmërisë në nivele më të larta të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale të arritura, dhe që janë në fuqi, në marrëveshjet tjera shumëpalëshe, dhe që në bazë të atyre marrëveshjeve janë pranuar nga të gjithë anëtarët e OBT-së, mund të drejtohen në Konferencën ministrore për veprime në përputhje me paragrafin 6 të nenit X të marrëveshjes së OBT-së, në bazë të propozimit të Këshillit TRIPS që do të miratohet me konsensus.

*Neni 72*

*Rezervat*

Pa pëlqimin e të gjithë vendeve anëtare nuk mund të deklarohen rezerva në raport me çdo dispozitë të kësaj marrëveshje.

*Neni 73*

*Përjashtime për arsye sigurie*

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet:

(a) se detyron një vend anëtar të jap çfarëdo informacioni, zbulimin e së cilit e konsideron në kundërshtim me interesat e veta thelbësore të sigurisë; ose

(b) se parandalon një vend anëtar të ndërmarrë veprime që i konsideron si të domosdoshme për mbrojtjen e interesave të veta thelbësore të sigurisë;

(i) në lidhje me materialet e zbërthyeshme apo materialet prej të cilave ato rrjedhin;

(ii) në lidhje me trafikimin e armëve, municionet dhe pajisje ushtarake, dhe tregtinë me mallra të tjerë dhe lëndë të para që përdoren drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte për qëllimet e furnizimit të institucioneve ushtarake;

(iii) që ndërmerren në kohë të luftës apo në situata të tjera të jashtëzakonshme në marrëdhëniet ndërkombëtare; ose

(c) se parandalon një vend anëtar të ndërmerr çfarëdo veprimi për zbatimin e detyrimeve të tij në bazë të Kartës së Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.